



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 12 (827867)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 22 mars 2024

Ministri Peleshi: Shqipëria, e angazhuar për të luajtur rol parësor për rivendosjen e sundimit të së drejtës ndërkombëtare dhe garantimin e sigurisë europiane



SHSHPFA gjeneralmajor Arben Kingji mori pjesë në ceremoninë e 25 - vjetorit të krijimit të Kompanisë EOD

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji, mori pjesë në ceremoninë e 25 - vjetorit të krijimit të kapacitetit kombëtar të asgjësimit të municioneve dhe eksplozivëve, kompanisë EOD.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm gjithashtu zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mhillaj, atashëu i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, kolonel Eric Cote, familjarë të dëshmorëve të rënë në krye të detyrës dhe të ftuar të tjerë.

Në përshëndetjen e tij në këtë përvjetor të 25-të të kompanisë EOD, gjeneralmajor Kingji shprehu vlerësim maksimal për përkushtimin dhe ekspertizën e jashtëzakonshme që personeli i kësaj kompanie ka treguar ndër vite. “Bilanci prej një çerek shekulli i Kompanisë EOD, përfshin mijëra hektarë sipërfaqe të pastruara nga municionet e paplasura mbi dhe nëntokësore, mijëra tonë eksplozivë të asgjësuar të llojeve dhe kalibrave të ndryshme, dhjetëra grup - depo të certifikuara, mbështetje e projekteve strategjike siç është ai i gazsjellësit TAP dhe Bazës Ajrore të Kuçovës, si dhe pjesëmarrje dinjitoze në misionet ndërkombëtare, si ALTHEA në Bosnje dhe Hercegovinë, EUTM në Mali dhe Grup - Batalioni i NATO-s në Letoni...”, - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Kingji.

Gjatë fjalës së tij, SHSHPFA vuri theksin në sakrificat e personelit, që ka shërbyer në këtë nën-repart ndër vite, një pjesë e të cilëve për fat të keq nuk jetojnë më. “... dhe në këtë ditë të shënuar, për historinë e kësaj njësie, përkulemi me nderim dhe respekt përpara kujtimit të Dëshmorëve të Atdheut, major Klodian Tanushi dhe nëntetare Zarife Hasanaj, si dhe kapter Agim Mekollari,



jtjes, duke e transformuar atë në një kapacitet të specializuar, i cili përveç angazhimeve brenda vendit, ajo mund të shfrytëzohet si kapacitet në misionet dhe operacionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB.

“Kontribut të veçantë në modernizimin dhe zhvillimin profesional të kompanisë EOD ka dhënë dhe aleati ynë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme në kompletimin me pajisje speciale, arsimimin dhe trajnimin e personelit të kësaj kompanie...”, - nënvizoi gjeneralmajor Kingji.

Ceremonia u përmbyll me një demonstrim nga ana e specialistëve të Kompanisë EOD, duke improvizuar situatën e një pakoje të dyshimtë të gjetur në një automjet, ku u përdorën pajisje dhe teknika bashkëkohore.

Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia priti në takim komandantin e Ekipit të Këshilltarëve dhe Trajnuesve britanikë

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia priti në një takim kortezie komandantin e Ekipit të Këshilltarëve britanikë, kolonel Paul Morris.

Gjatë takimit gjeneralmajor Xhebexhia falënderoi kolonelin Morris për ndihmën e pakursyer të këshilltarëve britanikë në drejtim të rritjes së nivelit drejtues të oficerëve të rinj të Forcave të Armatosura shqiptare, duke përmendur kursin “Junior Command and Leadership Course”, që po zhvillohet në FT.

Pasi theksoi bashkëpunimin e shkëlqyer midis dy ushtrive tona, komandanti i FT, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia u shpreh se:



“Lidershipi i Forcës Tokësore e vlerëson shumë traditën e mirë të zhvillimit të kurseve dhe trajnimeve nga ekipi britanik në Shqipëri, gjë që do të rrisë më tej bashkëpunimin në drejtim të aftësimit si teorik ashtu dhe praktik të oficerëve të rinj shqiptarë.” Kolonel Morris, duke e falënderuar komandantin e Forcës Tokësore për pritjen, vlerësoi bashkëpunimin midis dy ushtrive dhe u shpreh se ai dhe stafi i tij i trajnuesve do të jenë përherë të gatshëm për të rritur nivelin e trajnimeve dhe kurseve me efektivët e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.



Porti i Durrësit vizitohet nga nëndetësja turke “TCG Anafartalar” S(356)

Nëndetësja turke “TCG Anafartalar” S(356) e klasit “Preveze” realizoi një vizitë portuale në Portin e Durrësit.

Gjatë ditëve të qëndrimit në vendin tonë, komandanti i nëndetësës turke “TCG Anafartalar”, kapiten i rangut II Erce Yener, i shoqëruar nga atashëu ushtarak kolonel Tolga Kip, i emëruar në vendin tonë dhe disa efektivë të nëndetësës, zhvilluan një vizitë kortezie në Komandën e Forcës Detare/Rojës Bregdetare, ku u prit nga komandanti i Forcës Detare/Rojës Bregdetare, kundëradmiral Adnand Agastra. Kundëradmiral Agastra në fjalën e tij i uroi mirëseardhjen efektivit të nëndetësës në vendin tonë dhe theksoi vlerësimin e vizitës portuale si një angazhim i përbashkët për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet forcave detare të dy vendeve.

Komandanti i nëndetësës, kapiten i rangut II Erce Yener falënderoi për mikpritjen dhe angazhimin e Forcës Detare/Rojës Bregdetare gjatë kësaj vizite portuale dhe çmoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, i cili është shumë i rëndësishëm për ndërvëprimin ndërmjet dy forcave detare.



Ministri Peleshi: Shqipëria, e angazhuar për të luajtur rol parësor për rivendosjen e sundimit të së drejtës ndërkombëtare dhe garantimin e sigurisë europiane

Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, drejtoi takimin e aleatëve të Ukrainës në bazën ajrore amerikane të Ramstein në Gjermani, për të diskutuar për mënyrat se si të rritet mbështetja ushtarake për Kievin, përderisa paketa e ndihmës në vlerë prej 60 miliardë dollarësh vazhdon të jetë e bllokuar në Dhomën e Përfaqësuesve për shkak të kundërshtimit të republikanëve.

Takimi mujor i Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes së Ukrainës, i njohur edhe si Formati i Ramstein-it, përbëhet nga 50 shtete që mbështesin Ukrainën, dhe po mbahet në kohën e rritjes së shqetësimeve se forcat ukrainase po mbesin pa municion dhe armë të rënda të avancuara, teksa ato po përballen me forcat ruse që po përparojnë në frontin lindor. Pentagoni tha se gjatë takimit ai do të përsërisë qëndrimin se Uashingtoni mbetet i përkushtuar ndaj Ukrainës.

Sekretari Austin edhe një herë ka ftuar ministrat e Mbrojtjes dhe zyrtarët e lartë ushtarakë nga e mbarë bota për të diskutuar për krizën në Ukrainë dhe për çështje të tjera të sigurisë, me të cilat përballen aleatët dhe partnerët e SHBA-së.

Përderisa paketa e ndihmës në vlerë prej 60 miliardë dollarësh vazhdon të jetë e bllokuar në Dhomën e Përfaqësuesve, SHBA-ja më 12 mars njoftoi për një paketë të ndihmës ushtarake për Ukrainën në vlerë prej 300 milionë dollarësh. Kjo shumë është marrë nga Pentagoni.

Ndihma ushtarake evropiane për Ukrainën është bërë kritike për trupat ukrainase që po përballen me superioritetin e armikut, si në numër të ushtarëve, por edhe në numrin e municioneve të artillerisë që shpenzojnë në baza ditore në fushëbetejë.

Pjesë e rëndësishme e këtij takimi ishte dhe Ministri i mbrojtjes Niko Peleshi, i cili bëri të ditur se gjatë takimit u diskutua mbi bashkëpunimin e



sigurisë për Ukrainën.

Në kuadër të asistencës dhe ndihmave ushtarake, Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Shqipërisë, deri më tani kanë akorduar disa paketa ndihmash dhe asistencë ushtarake. “Shqipëria mbetet e angazhuar për të luajtur një rol parësor në përpjekjet ndërkombëtare për rivendosjen e sundimit të së drejtës ndërkombëtare dhe garantuar sigurinë europiane”, u shpreh Peleshi.



“
Ndihma ushtarake evropiane për Ukrainën është bërë kritike për trupat ukrainase që po përballen me superioritetin e armikut, si në numër të ushtarëve, por edhe në numrin e municioneve të artillerisë që shpenzojnë në baza ditore në fushëbetejë.

SHBA - Karta e Adriatikut, Shqipëria drejton takimin e përfaqësuesve të tetë vendeve

Nën kryesimin e Shqipërisë, u mbajt në Tiranë “Takimi i përbashkët i drejtorëve politikë të Ministrive të Jashtme dhe të Mbrojtjes”, në kuadër të Iniciativës SHBA - Karta e Adriatikut.

Takimi u bashkë-drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm i Politikave të Mbrojtjes z. Gjergji Methoxha si dhe drejtori i NATO-s në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme z. Petrika Jorgji.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Ministrive të Jashtme dhe të Mbrojtjes të Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut si dhe të SHBA-së, Kosovës, Sllovenisë dhe Serbisë.

Gjatë takimit u prezantuan prioritetet, të cilat do të jenë në fokusin e Shqipërisë gjatë kryesimit të SHBA - Karta e Adriatikut në vitin 2024, ku një nga prioritetet kryesore vijon të mbetet “Politika e Dyerve të Hapura” për shtete, të cilat aspirojnë të jenë pjesë e Kartës së Adriatikut dhe plotësojnë të gjitha kushtet për të qenë anëtarë të denjë të saj.

Një vëmendje të shtuar mori dhe angazhimi i vendeve të Kartës në misionet dhe operacione ndërkombëtare, duke nënvizuar dhe kontributin e vendit tonë për të marrë pjesë në misionet të përbashkëta në kuadër të NATO-s, BE-së dhe Kombeve të Bashkuara si dhe në angazhime të tjera në kuadër të stërvitjeve dhe trajnimeve



të përbashkëta.

Pjesëmarrësit diskutuan mbi situatën politike dhe atë të sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë, identifikuan sfidat e përbashkëta si dhe adresuan çështje konkrete në lidhje me bashkëpunimin në të ardhmen, duke vënë theksin në rëndësinë e procesit të integritetit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian, NATO dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Në fund të takimit, Ministria e Mbrojtjes prezantoi kalendarin e aktiviteteve, të cilat do të zhvillohen gjatë vitit në vendin tonë.





Forcat e Armatosura triumfojnë në Kampionatin European të Atletëve Master, Poloni

Forcat e Armatosura triumfojnë në Kampionatin European të Atletëve Master në Poloni, duke vendosur një rekord të ri për këta atletë në Shqipëri me rezultatin 09:03:98. Major Bledar Mesi dhe major Gerant Qiricit korrën suksesin e radhës. “Mirënjohje për përpjekjet e të gjithë efektivëve të FARSH-së, që me punën e tyre ngrenë lart emrin dhe flamurin e vendit tonë!”, - do të shprehej Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi në urimin e tij, drejtuar atletëve tanë.



Përfundoi Kursi Bazë i Nënoficerit II

Në mjediset e Qendrës Stërvitore në Komandën Mbështetëse, u zhvillua ceremonia për përfundimin e Kursit Bazë të Nënoficerit II. Në këtë kurs u trajnuan 20 ushtarakë, 11 prej të cilëve janë pjesë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në këtë ceremoni mori pjesë zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zyla dhe atashet ushtarakë në Kosovë në Shqipëri, kolonel Enver Hoti. Në fjalën e tij përshëndetëse, zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse falënderoi kursantët për përkushtimin, profesionalizmin e treguar dhe shkëmbimin e njohurive dhe eksperiencave.

Me anë të programeve dhe kurrikulave të ndjekura nga Qendra Stërvitore, ushtarakët e Forcave tona të Armatosura dhe ata të FSK-së, kanë rritur aftësitë e tyre profesionale në specialitetet xhenio, furnizim, transport mirëmbajtje dhe armatim-municion.



Përfaqësuesit e KM morën pjesë në “Konferencën IX vjetore të mbështetjes xheniere dhe logjistike të luftimit”

Shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Idriz Kuca dhe shefi i Shtabit të Batalionit të Xhenios, nënkolonel Artan Azizi, morën pjesë në “Konferencën e IX Vjetore të Mbështetjes Xheniere dhe Logjistike të Luftimit” - (Combat Engineer & Logistics Conference - CEL), në Varshavë, Poloni, organizuar nga “Defence Leaders”.

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues nga 50 shtete të ndryshme, përfshirë dhe vende anëtare të NATO-s dhe vende të tjera aleate dhe partnere. Në përfundim të aktivitetit, ekipi i Komandës Mbështetëse u prit në një takim informal nga ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Poloni znj. Mimoza Halimi.



KLSM-14 viziton Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura

Pjesëmarrësit në kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, KLSM-14, të shoqëruar nga stafi drejtues vizituan Shtabin e Përgjithshëm të FA-së. Ata u pritën në takim nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneralmajor Arben Kingji, i cili pasi u uroi mirëseardhjen, vlerësoi mundësinë që ofron ky kurs për të kuptuar më mirë dinamikën në mjedisin e sigurisë, natyrën e konflikteve në shekullin e 21-të dhe problematika të tjera në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Në vijim, gjeneralmajor Kingji u ndal në mjedisin e sigurisë në Ballkanin Perëndimor dhe rëndësinë e saj për sigurinë në zonën Euro - Atlantike, duke theksuar rolin konstruktiv të vendit tonë për paqen, bashkëpunimin dhe stabilitetin rajonal, rol i cili do të intensifikohet dhe më tej gjatë këtij viti, me anë të kryesimit të vendit tonë të dy iniciativave rajonale të Kartës së Adriatikut dhe asaj të Shefave të Shtabit të Ballkanit.



Në kuadër të NATO-s, gjeneralmajor Kingji vlerësoi masat e marra nga Aleanca për shkurajimin dhe mbrojtjen, dhe planet rajonale si mënyra më e mirë për sigurimin e integritetit territorial të Aleancës. Në këtë drejtim, ai i informoi mbi punën që po bëhet për përditësimin e planit tonë kombëtar të mbrojtjes dhe harmonizimin e tij me planin rajonal të Aleancës për Evropën Juglindore.

Po kështu, gjeneralmajor Kingji u ndal në kontributin e FARSH-së në misionet dhe operacionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB, duke theksuar vendimin për të rritur dhe më tej kontributin gjatë këtij viti në Kosovë, Bosnjë Hercegovinë, dhe Rumanë.

Në linjë me Direktivën e Mbrojtjes dhe vizionin e tij si shef i SHPFA-së, ai i njohu pjesëmarrësit me disa nga zhvillimet kryesore në FARSH, duke u ndalur në përmirësimet ligjore me fokus rregullimin e marrëdhënies së komandim kontrollit dhe përmirësimin e trajtimit të personelit; rishikimin e dokumenteve strategjike, ku pas miratimit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, po punohet për rishikimin e Strategjisë Ushtarake dhe Planin Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2024 - 2033; projektet e modernizimit me fokus rritjen e fuqisë së zjarrit dhe kapacitetet e mbrojtjes kibernetike, etj.

Më pas më anë të prezantimit të dhënë nga drejtori i drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes në SHPFA, kolonel Elton Bregu pjesëmarrësit u njohën me: historikun e FA-së, misionin, komandim-kontrollin, strukturën aktuale të FA-së, bashkëpunimin ndërkombëtar, planet e modernizimit, kontributi i FA-së në Emergjencat Civile dhe angazhimet e viteve të fundit, pjesëmarrja në misionet paqeruajtëse si dhe angazhimet e fundit në stërvitjet ndërkombëtare. Pjesëmarrësit drejtuan pyetje dhe takimi u realizua në formën e bashkëbisedimit.



KKSHP, vizitë në Radio Televizionin Shqiptar

Kursantët e kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë zhvilluan vizitë në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH). Në kuadër të programit mësimor “Departamenti i Udhëheqjes Ushtarake”, me kursantët e kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP) zhvilluan vizitë në ambientet e RTSH-së.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte njohja e pjesëmarrësve me rolin e mediave dhe komunikimit në një mjedis operacional që po ndryshon, me historikun e RTSH-së si media audiovizive me status të veçantë si dhe sfidat e zhvillimeve teknologjike në tregun mediatik dhe atyre sociale.

Në RTSH kursantët u pritën nga Drejtori i Akademisë së Trajnimeve z. Elton Metaj, i cili bëri një prezantim të gjerë në lidhje me çështjet e mësipërme si dhe mbi organizmin, funksionimin dhe ruajtjen e autonomisë institucionale dhe pavarësisë editoriale!

Vizita më pas vijoi në studiot ku përgatiten programe të ndryshme televizive, në të cilat stafi regjizor, gazetar, operator etj., i njohu më nga afër me procesin e grumbullimit, analizës, përgatitjes dhe transmetimit të lajmeve dhe programeve televizive. Kjo ishte edhe një mundësi për pjesëmarrësit për t'u njohur dhe parë nga afër teknologjitë nga më bashkëkohoret të instaluar në vitet e fundit. Stafi i RTSH-së e vlerësoi shumë këtë vizitë, duke shprehur mirëpritjen për vizita të tjera mësimore.



EOD, 25 vite histori krenarie, guximi, trimërie

Në 19 mars 1999, në Forcat e Armatosura mori jetë një grup i ri ekspertësh dhe profesionistësh xhenerë, i kompletuar me ekspertizën e duhur në lëmin e asgjësimit të municioneve të paplasura. Në këtë nënrepart u thirrën më të mirët e të mirëve, pasi ky profesion kërkon guxim, dhe qartësi, për të marrë vendimin e duhur, ku jetën nga vdekja e ndan vetëm një vijë e hollë e padukshme. Për 25 vjet kjo strukturë na ka bërë krenarë si brenda dhe jashtë vendit, duke ngritur për herë të parë flamurin tonë në Bosnjë, në Mali, Letoni etj.

Prej ditës së parë të krijimi të grupit të asgjësimit të municioneve të tepërta e të rrezikshme, kompania EOD (Explosive Ordnance Disposal) vjen me një bilanc pune të jashtëzakonshëm.

Mbi 1 mijë hektarë sipërfaqe të pastruara nga municionet e paplasura, mbi dhe nëntokësore. Mbi 55 mijë tonë municione të asgjësuar, të llojeve të ndryshme dhe kalibrave të ndryshëm. 15 grup-depo të certifikuar dhe pjesëmarrje në misionet ndërkombëtare, si “Althea” në Bosnje dhe Hercegovinë, EUTM Mali, dhe grup – batalioni i NATO-s në Letoni.

Falë punës së specialistëve EOD, vendi ynë tani është më i pastër nga minat dhe eksplozivët e paplasur.

Por për të arritur deri këtu u desh dhe gjaku i 5 martirëve që dhanë jetën në krye të detyrës, e sot emri i tyre është gdhendur në historinë e ndritur të këtij reparti për t’u kujtuar përjetë.

Kjo komandë është e jashtëzakonshme nga rëndësia që ka në mbështetjen e operacioneve dhe jashtë vendit, tashmë ka fituar edhe një emër në hapësirën e NATO-s. Njësia EOD, e cila shërben në Letoni prej vitesh me rrotacion çdo 6 muaj është një kapacitet i madh tashmë i njohur edhe nga shtetet e tjera dhe që me të vërtetë, ndonëse jemi një vend i ri dhe i vogël në këtë aleancë, në këtë kapacitet specifik kemi bërë emër shumë të mirë dhe kemi marrë falënderime.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, me rastin e 25-vjetorit të krijimit të kësaj komande, do të shprehej se: “Kjo është rruga, përmes së cilës duhet të ecim, nga njëra anë duhet të forcojmë kapacitetet e brendshme dhe të jemi më të shkathët, më prezentë pranë qytetarëve sa herë që të jetë e nevojshme, duke mbështetur operacione humanitare dhe civile, por edhe t’i zbardhim faqen Shqipërisë dhe FA-së me kapacitetet tona të veçanta si ai EOD në Letoni, por dhe kudo tjetër. Situata që po kalojmë është një situatë me dinamika, e turbullt herë pas here, me sfida, ndaj ne duhet të jemi të përgatitur për më të keqen, për të mbështetur frontin e parë, siç është dhe misioni i kësaj komande”.




FALË PUNËS SË SPECIALISTËVE EOD, VENDI YNË TANI ËSHTË MË I PASTËR
NGA MINAT DHE EKSPLOZIVËT E PAPLASUR.

POR PËR TË ARRITUR DERI KËTU U DESH DHE GJAKU I 5 MARTIRËVE QË
DHANË JETËN NË KRYE TË DETYRËS, E SOT EMRI I TYRE ËSHTË GDHENDUR
NË HISTORINË E NDRITUR TË KËTIJ REPARTI PËR T’U KUJTUAR PËRJETË.
KJO KOMANDË ËSHTË E JASHTËZAKONSHME NGA RËNDËSIA QË KA NË
MBËSHTETJEN E OPERACIONEVE DHE JASHTË VENDIT, TASHMË KA FITUAR
EDHE NJË EMËR NË HAPËSIRËN E NATO-S.



Shfrytëzo anët pozitive të teknologjisë, por mos lejo që teknologjia të të shfrytëzojë ty



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

E di që nuk kontrollohet dot makineria gjigande e rrjeteve sociale, por kontrolloni fëmijët, sa të mundni njerëz...

Pak ditë më parë mediat publikuan lajmin e radhës: një i ri 17 vjeçar u vra nga bashkëmoshatarët e tij prej disa ngacmimeve në 'Tik-tok', nuk arritëm të kapërcenim dhimbjen e parë, një tjetër lajm: një vajzë e vogël përndiqej nga rrjetet sociale nga një pedofil, dhe vetëm pas dy orësh: një grua vetëvritet prej publikimeve që të afërm të saj i kishin bërë në 'Facebook'. Kjo, kronika e një dite. Po sa të tilla dëgjojmë çdo ditë?!

Çfarë po ndodh me shoqërinë shqiptare dhe pamundësinë për të frenuar rrjetet sociale të shkatërrojnë jetën tonë?

Sado madhore, ose jo, qofshin, gjithkush ka pasiguritë e tij. Kushedi sa e sa herë na ndodh të krahasohemi me të tjerët ndërkohë që shohim një foto me linja trupore perfekte, tipare harmonike apo veshje marramendëse. shumë njerëz vuajnë nga "zilia e Facebook-ut".

Sa kohë harxhojmë duke kontrolluar jetët e të tjerëve mund të fokusoheni te jeta jonë dhe të punojmë për të rritur vetëbesimin dhe për të qenë versioni më i mirë i vetes sonë.

Teknologjia ia ka dalë të na largojë nga miqtë apo të afërmit

Në vend që të lëmë një takim dhe të shkojmë t'i takojmë ballë për ballë njerëzit, t'i prekim, t'i përqafojmë, t'i shohim në sy, mjaftohemi me dy mesazhe në ditë. Rrjetet sociale ia kanë dalë të na rrëmbejnë edhe çastet më të bukura në jetë. Me një celular në duar, një çast i bukur është një çast i humbur. Mania e frikshme për të bërë medoemos foton perfekte, që më pas do



bërë antisocialë. Të mbyllur në vetvete dhe shpesh të mbyllur edhe në shtëpi. Nuk mund të dalësh në rrugë dhe të mos shikosh dikë me telefon në dorë. Mund të përplasesh me ta apo më e keqja mund të bëhen edhe burim aksidentesh. Shpesh edhe në kafe kur shikon një grup të rinjsh ata të gjithë janë duke u marrë me telefonat e tyre dhe vazhdojnë punët e tyre duke harruar se ku ndodhen.

Telefonat dhe rrjetet sociale janë një shqetësim edhe për mësuesit edhe prindërit. Shumë nxënës merren me telefon edhe gjatë kohës që janë në shkollë. Kjo shkakton humbjen e përqendrimit dhe sjell rezultate shumë të ulëta në mësim.

A kanë sjellë rrjetet sociale shtimin e rasteve të bullizmit, abuzimeve seksuale deri në prostitucion?

Rrjetet sociale na japin mundësinë të komunikojmë me njerëz në të gjithë botën.

Këta mund të jenë njerëz të panjohur për ne. Duke mos i njohur, vetëm me anë të fjalëve

të tyre, ne mund të mashtrohemi dhe të biem pre e abuzimeve të ndryshme. Nuk janë të pakta rastet e tilla të bëra publike vitet e fundit.

Rrjetet sociale po përdoren edhe për mashtrimin e njerëzve

Raste të tilla janë edhe rekrutimi i të rinjve nga ISIS. Ata komunikojnë me të rinjtë nëpërmjet 'Facebook-ut', apo rrjeteve të tjera dhe i bindin ata që të bëhen pjesë e tyre. Teknikat dhe fjalët bindëse që ata përdorin arrijnë t'i bëjnë për vete këta të rinj.

Kur shikon që të rinjtë janë të gatshëm të ndajnë çdo gjë të jetës së tyre dhe me këdo në rrjetet sociale, të mundon pyetja: a

është ky një dimension i ri lirie, ku ky brez shfaqet si një libër i hapur apo është një fenomen që po mundohet të na tregojë një problem?

Pse duan të jetojnë jetën e tyre edhe në rrjetet sociale dhe ndoshta më shumë aty, sesa realitetin?

Adoleshentët dhe të rinjtë duhet t'i përdorin sa më pak dhe duhet të kenë një moshë të caktuar dhe madje edhe një limit kohor për t'i përdorur. Këto nuk arrihen vetëm me kontrollin e prindërve, por edhe me politikat e themeluesve të këtyre rrjeteve sociale.


Pas revolucionit industrial, i cili furishëm përcaktoi edhe shndërrimin e shoqërive nga tradicionale në ato moderne, në dekadat e fundit zhvillimi dixhital e përshpejtoi ndryshimin e mënyrës se si ne iu qasëm këtij moderniteti. Ndërsa vitet e fundit, ne sot, po përballemi me një revolucion tjetër që është "revolucioni i touch screen-it", i cili e personalizoi realitetin dhe boshitin e tij drejt individit.

Individi u kthye në qendër të këtij revolucioni dhe kahja sociale nuk është më nga një shoqëri drejt individit, por tashmë ne sot me "touch technology" i qasemi realitetit nga individ drejt shoqërisë. Në këtë këndvështrim, individ si përdorues i teknologjisë, merr attribute të rëndësishme sociale. Ai në të njëjtën kohë është kudo, por në të njëjtën kohë realisht ndodhet i vetmuar në qelinë e tij dixhitale.

Seksualiteti i tepruar ka vrarë ndjenjën e sensualitetit

Sot rrjetet sociale, 'Instagram', FB, ngjajnë të gjitha si një panair prej mishi njerëzor, një skllavëri e vetë dëshiruar, ku njerëzit shesin hiret e tyre për para. E gjitha kjo shkakton pasoja të pariparueshme në ndërgjegjen dhe shpirtat e përdoruesve dixhitalë. Pasojat pastaj janë të shumanshme. Ato shkarkojnë përgjegjësinë e individit ndaj të tjerëve në saje të mungesës së kontaktit fizik.

I gjithë ky zhvillim, kjo qasje drejt një bote ende të panjohur dhe si e tillë e pamundur për të përdorur armët mbrojtëse, duhet të na bëjë të paktën më vigjilentë, ndaj këtij 'bumi' teknologjik në duart e fëmijëve tanë.



të reklamohet kudo, na pengon ta shijojmë momentin siç bënim dikur, për të gjithë ata që kanë patur fatin t'i jetojnë ato kohë. Kaq jetike është shndërruar sot një rrjet social sa e kapim veten gjithë ditën duke folur rreth tij, duke qëndruar në të për orë e orë të tëra dhe duke u betuar çdo ditë se të nesërmen do të jetë ndryshe, nuk do të qëndrojmë më aq shumë, nuk do të merreni më me vogëlsira dhe se do t'u jepemi prioriteteve të tjera, gjërave frytdhënëse në jetë. Sa herë ia kemi dalë ta bëjmë këtë? Shumë pak, ose më mirë kurrë. E pra, teknologjia ia doli, fitoi ndaj nesh!

Një problem shumë i madh është izolimi i të rinjve. Ata janë



KUJTIM BORIÇI

Takim mbresëlënës i oficerëve dibranë në Peshkopi. Mall, dashuri e krenari për dekadat në Forcat e Armatosura, nderim për kolegët ‘Dëshmorë të Atdheut’ dhe vendosmëri, për të qenë kurdoherë të gatshëm për Kombin.

Në qytetin e Peshkopisë, ‘Qytetit të blirëve’, grupime të shumtë ushtarakësh (aktiv e rezervistë), u mbledhën së bashku në vendlindje, me objektin: “Na mbledh dashuria për vendlindjen, kombin dhe betimi ushtarak!”. Grupe ushtarakësh, (burra e gra) gjeneralë, kolonelë, familje të të rënëve, “Dëshmorë të Atdheut”, fillimisht populluan bulevardin qendror të qytetit, më pas mbushën sallën qendrore të Pallatit të Kulturës “Haki Stërmilli”, ku u bë dhe aktiviteti ceremonial.

U mbledhën në këtë ditë, breza ushtarakësh e kujtuan dekadat në punë në këtë trevë e gjithë Shqipërinë, kujtimet e tyre nga misionet e përbashkëta me aleatët në vatrat e luftës jashtë vendit, duke shprehur dashuri, nostalgji, mall e njëkohësisht krenari për dinjitetin që kanë treguar në përmbushje të betimit ushtarak dhe detyrave që iu janë ngarkuar. Kishte takime mes disave, që ndodhnin dhe pas 40-50 apo 60 viteve.

Sigurisht, më i preokupuar në këtë ditë, ishte gjeneral Dilaver Laçi si kryeorganizator, bashkë me gjeneral Gjergj Vladin dhe Avni Met’hasanin, që ishin përkujdesur deri në detaje për mbarëvajtjen e këtij takimi. Në këtë takim, u kujtuan dhe 6 ushtarakët “Dëshmorë të Atdheut” dhe kolegëve të ndarë natyrshëm nga jeta në këto dekada.

Ndërsa krejt i veçantë ishte dhe koncerti që kishte përgatitur për këtë rast, Ansambli i Dibrës, i Pallatit të Kulturës “Haki Stërmilli”.

Për nga mënyra e organizimit, pjesëmarrja dhe mesazhet, takimi i oficerëve dibranë, i pari i këtij lloji në vend, pati vlera të veçanta, duke konfirmuar dhe një herë se “Ushtarakët kanë qenë kurdoherë shtresë vitale e shoqërisë shqiptare, të ndërgjegjshëm dhe besnikë të atdheut deri në sakrificën e fundit, dhënien e jetës!”.

Aktiviteti

Mbrëmjen e dy ditëve para aktivitetit, teksa isha në punë në gazetë, bie zilja e telefonit. Ishte gjeneral Dilaver Laçi, me të cilin kisha disa kohë pa komunikuar.

- Dilaveri jam, këtë javë do takohemi në Peshkopi, do mblidhemi oficerët dibranë. Sigurisht që ju do vini. Takohemi atje, - më tha.

- Po mirë mo, shyqyr që po bashkohemi edhe njëherë si dikur, në kohërat kur supëve mbanim kostumin ushtarak, dashurinë për “armën” dhe sakrificën deri në vetëmohim, - iu përgjigja. Gjithsesi, mëngjesin e kësaj dite, udhëtuam së bashku drejt Peshkopisë.

...Në çeljen e aktivitetit në Pallatin e Kulturës, fillimisht u shoqërua Himni Kombëtar. Në vijimësi, u kujtuan dhe u mbajt një minutë heshtje për oficerët dibranë, “Dëshmorë të Atdheut”, rënë në krye të detyrës, Përkatësisht: Sefedin Tomçini, pilot; Sabri Toçi, pilot; Florian Delija, pilot; Klodian Tanushi, oficer; Hajrulla Tollja, oficer; Mehmet Hysa, oficer. Njëkohësisht, po me një minutë heshtje, u kujtuan dhe 74 oficerët dibranë që kanë ndërruar jetë për shkaqe natyrale.

Fjalën përshëndetëse, e mbajti, gjeneral Dilaver Laçi, i cili, ndër të tjera tha:

“... Sot jemi kaq, është hera e parë që mblidhemi, e jam i sigurt se radhën tjetër do të jemi shumë, disa herë më shumë se kaq! Se na thërret vendlindja, tradita e mrekullueshme dibrane, historia e lavdishme e të parëve tanë, trashëguar ndër breza! Kemi pse



Dashuria për vendlindjen dhe kombin mbledh oficerët dibranë



mblidhemi, kemi çfarë të kujtojmë e çfarë të themi ne oficerët dibranë, se ndër vite e dekada, kemi qenë në ballë të punëve, fisnikë e të betuar për të dhënë jetën për kombin, për interesat mbarë shqiptare! Ikëm fëmijë që këtu, u burrrëruam nëpër shkolla, e punuam me devocion, këtu e në mbarë Shqipërinë, në frontin e luftës për lirinë e Kosovës, në frontet e luftës me aleatët në shumë pika nevralgjike, ku rrezikohet demokracia e liria në botë. Dhe gjithmonë, ishim e jemi në vijë të parë, brezat para nesh, ne, brezi i sotëm dhe brezat që do vijnë. Kemi mes nesh komandant Ismailin, gjeneralë dhe kolonelë dibranë, oficerë madhorë e oficerë të funksioneve të ndryshme, që kanë lënë gjurmë në historinë e traditën dibrane, në strukturat e Forcave tona të Armatosura. Pra, kemi përse të krenohemi ne oficerët dibranë! Shpresoj e besoj që këto takime në vendlindje të kthehen në traditë...”.

Kujtime, mall e krenari

Në podium, u ngritën e sollën kujtime, shumë ushtarakë të tjerë, që sollën kujtime, mallin për shokët e dikurshëm, krenarinë dhe gatishmërinë për të qenë kurdoherë të gatshëm nëse atdheu i kërkon...

Ismail Shulku

(Kolonel):

“...Si ndër më të moshuarit në këtë takim, sot, ndjej emocion si asnjë herë në jetën time. Urime organizatorëve! Është takim i veçantë ky i joni, që na sjell mall e krenari. Jo thjeshtë si takim, pasi ka dekada që disa takojnë njëri-tjetrin sot, por dhe për krenari të traditës vëllazërore dibrane. Oficerët dibranë kanë qenë, janë e do të jenë kurdoherë në ballë të detyrave karshi atdheut. Nga gjiri jonë kanë dalë ministra, deputetë, gjeneralë, komandantë të njësive operative, diplomatë e ambasadorë. Gjeneralja e parë e Ushtrisë Shqiptare, zëvendëse e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, në detyrë, është dibrane. Pra, kemi çfarë të themi... Mendoj të takohemi periodikisht, në data të caktuara, e kjo të mbetet traditë brezash...”.

Gjeneral Xhemal Gjunkshi (ish-shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së):

“...Jam i emocionuar nga ky takim, që është i veçantë në llojin e vet. Kemi punuar me përkushtim në dekada, kemi lënë gjurmë si



dibranë, në përmbushjen e misionit të oficerit aktiv, bashkë me kolegë të trevave të tjera të ushtrisë. Ta kthejmë këtë në një traditë...”.

Gjeneral Gjergj Vladi: “...

Të jemi krenarë për çfarë kemi dhënë ne dibranët, si ushtarakë aktivë, nga kapiteni i thjeshtë, deri tek gjeneralët e oficerët madhorë, duke filluar nga heronjtë e kombit e tribunët tanë popullorë: Nga Skënderbeu që ka vendlindje Dibrën, Ilias Pashk Dibrën, kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; Nikoll Kaçorrin, zëvendëskryeministrin e Shtetit të Parë Shqiptar; Heroin Gjokë Doçi; Ibe Palikuqin, heroinë; Nazmi Rushitin, hero i luftës; Hajrulla Tollen e Mehmet Hysën, oficerë të rënë në krye të detyrës; Komandant Ismail Shulkun; Gjeneralët dibranë, Hysen Rrepa; Manushaqe Shehu; Xhemal Gjunkshi; Zyber Dushku; Dilaver Laçi; Bardhyl Hoxha; Ali Koçeku; kolonelë, mjekë të talentuar ushtarakë; pedagogë të shumtë të Akademisë Ushtarake etj....”.



Jahe Delia, (babai i pilotit ‘Dëshmor i Atdheut’, Florian Delia):

“...Faleminderit për këtë organizim dhe ftesën që më bëtë. Djali im, Floriani, do të ishte sot këtu mes jush. Por ai u vra në krye të detyrës, e sot unë jam në vend të tij. Do të jem kurdoherë mes jush, unë dhe familja ime, në ditë të mira e ditë të liga. Kur ju shoh ju, më duket se kam dhe Florianin këtu, më duket se e kam të gjallë... Faleminderit!”.

Remzi Çakrri (Kreu i SHKSHURSH, Dibër):

“... Me këtë aktivitet sot, ne oficerët dibranë, tregojmë se kemi qenë e do të jemi kurdoherë dinjitozë, kurdoherë të gatshëm për nevojat e atdheut. Pavarësisht moshës që kemi... Mirë u takofshim përsëri...”.

Prologu dhe mesazhet

Befasi që ishte mbajtur sekret, ishte fakti që në fund të ceremonisë zyrtare, Ansambli i Pallatit të Kulturës, dha një koncert të pasur me këngë dibrane të traditës, konceptuar e përgatitur, enkas për këtë rast. U duartrokitën interpretimet e këngëtarëve Agim Skara, Edmond Pernexha, Ylber Sopoti etj...

Të pranishmit, në fund konfirmuan grupin e organizatorëve dhe vendosën që një herë në vit, të mblidhen në Peshkopi oficerët me origjinë nga Dibra dhe grupimet, atje ku punojnë e jetojnë, në Tiranë, rrethe të tjera të Shqipërisë apo komunitete në emigrim, të takohen më shpesh. Në fund, të gjithë të pranishmit, drekuan së bashku në një nga lokalet e njohura të qytetit, në një atmosferë kujtimesh, dollish, këngësh e vallesh të shumta, deri në orët e vona të mbrëmjes së ditës, duke u ndarë me premtimin: “Mirupafshim prap në vendlindje!”.

Përshatja: MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg përfundoi turneun e tij treditur në Kaukazin e Jugut. Sekretari i Përgjithshëm mbërriti në Baku, më 17 mars 2024, duke nisur kështu turneun treditur dhe 3-kombësh në Kaukazin e Jugut.

Të hënën më 18 mars, Sekretari i Përgjithshëm u takua me ministrin e Jashtëm Jejhun Bajramov dhe ministrin e Mbrojtjes gjeneralkolonel Zakir Hasanov. Më pas ai udhëtoi në Tbilisi për takime me udhëheqjen e Gjeorgjisë. Presidentin Salome Zourabichvili dhe kryeministrin Irakli Kobakhidze.

Ndërsa më 19 mars Stoltenberg u takua me udhëheqjen e Armenisë në Jerevan, Presidentin Vahagn Khachaturyan dhe kryeministrin Nikol Pashinyan.

Në këto takime Sekretari i Përgjithshëm theksoi se stabiliteti në Kaukazin e Jugut ka rëndësi për NATO-n si dhe vlerësoi partneritetet e gjata dhe kontributet e këtyre vendeve në misionet e NATO-s. “Paqja dhe stabiliteti nuk janë vetëm të rëndësishme këtu, por edhe për sigurinë më gjerë”, - theksoi Stoltenberg.

Vizita në Baku, Stoltenberg mirëpret partneritetin e gjatë të NATO-s me Azerbajxhanin

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, në turneun treditur, 3-kombësh në Kaukazin e Jugut, u takua me Presidentin Ilham Aliyev, Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti bashkëpunimin e gjatë të Azerbajxhanit me Aleancën, duke thënë se ai pret me padurim forcimin e mëtejshëm të partneritetit.

Stoltenberg mirëpriti mundësinë për të diskutuar sigurinë energjetike, dhe tha se: “Energjia ka rëndësi për sigurinë tonë dhe mirëpres që Azerbajxhani po zhvillon lidhje gjithnjë e më të ngushta me disa aleatë të NATO-s”. Ai më tej vuri në dukje një aspekt historik të punës për çështjet me interes të përbashkët dhe falënderoi Azerbajxhanin për kontributin e tij në operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO, përfshirë në Kosovë dhe Afganistan, që kur Azerbajxhani iu bashkua Partneritetit për Paqe të NATO-s në vitin 1994.

Aleanca dhe Baku gjithashtu kanë bashkëpunim përmes programit “Shkencë për Paqe dhe Siguri të NATO-s për kundërterrorizmin dhe sigurinë kibernetike”.

Për situatën në Kaukazin e Jugut, Sekretari i Përgjithshëm nënvizoi se: “Paqja dhe stabiliteti nuk janë vetëm të rëndësishme këtu, por edhe për sigurinë më gjerë”. Ai tha se “Armenia dhe Azerbajxhani tani kanë një mundësi për të arritur një paqe të qëndrueshme pas vitesh konflikti”. Ai shtoi se: “Unë thjesht mund t’ju inkurajoj që të shfrytëzoni këtë mundësi për të arritur një marrëveshje paqeje të qëndrueshme me Armeninë”. Për Ukrainën, Stoltenberg përshëndeti mbështetjen shumë të nevojshme të ofruar nga Azerbajxhani dhe u bëri thirrje të gjitha vendeve në rajon që të rrisin mbështetjen: “Nevojitet më shumë mbështetje sepse situata në Ukrainë është jashtëzakonisht e vështirë”. Sekretari i Përgjithshëm e quajti samitin e ardhshëm global të klimës COP29 në Azerbajxhan një moment historik të rëndësishëm. “Është e rëndësishme për të gjithë shqetësimi për ndryshimet klimatike, por gjithashtu e rëndësishme është klima për sigurinë tonë, sepse ato çështje janë të ndërlidhura ngushtë”.

Të hënën, Sekretari i Përgjithshëm u takua me ministrin e Jashtëm Jejhv dhe ministrin e mbrojtjes gjeneralkolonelin Zakir Hasanov. Më pas ai udhëtoi në Tbilisi për takime me udhëheqjen e Gjeorgjisë.

Stoltenberg në Tbilisi: NATO mbështet sovranitetin dhe integritetin territorial të Gjeorgjisë

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg në turneun e tij në Kaukazin e Jugut, në ditën e dytë, më 18 mars 2024, u takua në Tbilisi të Gjeorgjisë me Presidentin Salome Zourabichvili dhe kryeministrin Irakli Kobakhidze.

“Gjeorgjia është një nga partnerët më të ngushtë të NATO-s. Ne e vlerësojmë shumë kontributin tuaj thelbësor në misionet dhe operacionet e NATO-s dhe mbështesim plotësisht sovranitetin dhe integritetin territorial të Gjeorgjisë. Osetia e Jugut dhe Abkhazia janë pjesë e Gjeorgjisë”, - tha Stoltenberg. Ai i bëri thirrje Rusisë që të anulojë njohjen e territoreve gjeorgjiane të Osetisë Jugore dhe Abkhazisë si shtete të pavarura dhe shtoi se organizimi i zgjedhjeve nga Rusia në pjesët e pushtuara të Gjeorgjisë dhe Ukrainës është krejtësisht i paligjshëm. “Zgjedhjet presidenciale të Rusisë nuk ishin qartësisht as të lira dhe as të drejta”, - tha Stoltenberg.

Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti kontributet e konsiderueshme të



Gjeorgjisë në operacionet e NATO-s dhe mbështetjen për Ukrainën. Gjeorgjia po pret mijëra refugjatë ukrainas dhe po ofron ndihmë të rëndësishme humanitare dhe financiare. “Rusia këmbëngul në ndjekjen e ambicieve të saj perandorake dhe në Ukrainë, situata në fushën e betejës mbetet e vështirë”, - tha ai. “Por, me mbështetjen tonë, Ukraina ka shtyrë prapa, duke shkatërruar ose dëmtuar një pjesë të konsiderueshme të flotës ruse të Detit të Zi, duke lejuar Ukrainën të rihapë transportin e drithit që është jetik për ekonominë e tyre dhe për sigurinë globale të ushqimit”.

Gjatë vizitës së tij, Sekretari i Përgjithshëm diskutoi mënyrat për të forcuar më tej partneritetin e NATO-s me Gjeorgjinë. NATO po rrit bashkëpunimin e saj me Gjeorgjinë në fusha të tilla si menaxhimi i krizave, siguria kibernetike, inxhinieria ushtarake dhe komunikimet e sigurt. Stoltenberg nënvizoi angazhimin e NATO-s për të mbështetur rrugën e Gjeorgjisë drejt një demokracie më të fortë dhe integritit të plotë euroatlantik, duke përfshirë vendimin e Bukureshtit të vitit 2008, që Gjeorgjia do të bëhet anëtare e NATO-s.

Ndërsa më pas, Sekretari i Përgjithshëm vazhdoi vizitën e tij treditore në Kaukazin e Jugut në Jerevan, duke u takuar me udhëheqjen e Armenisë.

Stoltenberg: Armenia dhe Azerbajxhanit të arrijnë një paqe të qëndrueshme për stabilitetin në Kaukazin e Jugut

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg e përfundoi turneun e tij në Kaukazin e Jugut, më 19 mars me vizitën në Jerevan, Armeni,



ku u takua me Presidentin Vahagn Khachaturyan dhe kryeministrin Nikol Pashinyan.

Stoltenberg vlerësoi Armeninë për partneritetin e saj të gjatë dhe kontributin në operacionet e NATO-s, duke përfshirë rritjen e numrit të trupave në misionin paqeruajtës të KFOR-it. “Për gati 20 vjet, Armenia ka qenë një partner kyç në misionin paqeruajtës të NATO-s KFOR, duke ndihmuar për të siguruar një mjedis të mbrojtur dhe të sigurt për të gjitha komunitetet në Kosovë”, - tha ai.

Për stabilitetin në Kaukazin e Jugut, Sekretari i Përgjithshëm i kërkoi Armenisë dhe Azerbajxhanit të arrijnë një marrëveshje për



të hapur rrugën për normalizimin e marrëdhënieve dhe një paqe të qëndrueshme. “Kjo ka rëndësi për sigurinë euro-atlantike, pasi ne përballemi me një botë më të rrezikshme,” - theksoi ai, duke përsëritur se “NATO mbështet sovranitetin dhe integritetin territorial armen, dhe aspiratat tuaja paqësore”.

Sekretari i Përgjithshëm paralajmëroi se “lufta e Rusisë në Ukrainë është një kujtesë kthjelluese, se ne nuk mund ta marrim paqen si të mirëqenë. Nëse Putini ka sukses në Ukrainë, ekziston rreziku real që agresioni i tij të mos ndalet me kaq dhe aktorët e tjerë autoritarë të trimërohen”, - tha ai. Stoltenberg u bëri thirrje të gjithë partnerëve të NATO-s që të “bëjnë atë që munden për të siguruar që Putini të mos fitojë luftën e tij të agresionit”. “Situata në fushën e betejës mbetet e vështirë, por kjo është një arsye për të rritur, jo për të zvogëluar mbështetjen tonë”, - tha ai.

Gjatë vizitës së tij, Sekretari i Përgjithshëm diskutoi përparimin në reformat e brendshme të Armenisë. Ai theksoi angazhimin e Armenisë për të siguruar kontrollin demokratik të forcave të saj të armatosura, duke përfshirë pjesëmarrjen në programin e ndërtimit të integritetit të NATO-s. “Ju keni treguar gjithashtu një angazhim të vërtetë për të luftuar korrupsionin, për të forcuar institucionet tuaja demokratike dhe për të mbështetur sundimin e ligjit”, - përfundoi ai.



PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI



IRFAN BIRBILAJ

(Në nderim të 80-vjetorit të rënies së dëshmorit të Fushëbardhës, Sami Sejdi Golemi si dhe shokëve të tij të Labërisë të rënë pranë Senicës së Delvinës. Mirënjohje Këshillit Bashkiak të Delvinës që miratuan njëzëri dhe firmosën ligjërisht Vendimin e Këshillit Bashkiak të Delvinës që mban nr.14 datë 30.3.2021, “Për miratimin e ngritjes së memorialit për 5 dëshmorë të LANÇ-it: Hasan Salih Çerepi 17 vjeç, Karafil Vehip Bello 42 vjeç, Sami Sejdi Golemi 37 vjeç, Sefer Ramo Meta 28 vjeç, Skënder Mato Pepiaj 19 vjeç, pranë fshatit Senicë të Delvinës).

Vitet kalojnë dhe u bënë dekada, nga rënia për atdhe e dëshmorëve të lirisë. Edhe pse kaluan tetë dekada, më i lartë është nderimi, mirënjohja dhe respekti për bartësit e idealeve të lirisë, për bijtë e bijat e Labërisë dhe mbarë kombit shqiptar, që gjakun e çimentuan me lirinë. Epitetet për lartësinë e piedestaleve e memorialëve kanë bazë të fuqishme kur kujtohen e respektohen me dinjitet e krenari. Nderimi dhe mirënjohja për dëshmorët është nderim e respektim i idealeve të kombit e flamurit. Një ndër luftëtarët e lirisë gjatë LANÇ-it ishte partizani i orëve të para Sami Sejdi Golemi, që jetën ia fali atdheut me përkushtim të jashtëzakonshëm për çështjen kombëtare të lirisë. Ai ra trimërisht në Senicë përtej Skërficës, Luvadhit e Zagonikut. Atje ku kishte rënë edhe trimi Karafil Bello, ranë në betejë më 14 mars 1944 edhe Sami Golemi, Hasan Çerepi, Sefer Meta, Skënder Pepiaj, pranë fshatit Senicë të Delvinës. Brezat e burrëruar në kohë baruti, pas luftës mbajnë në kujtesë një lapidar në formë koni si kujtesë lufte, në vendin e quajtur Qafa e Hanit, që fliste shumë për burrat që ranë për Atdheun, që gjakun e çimentuan me lirinë dhe merituan titullin e lartësuar “Dëshmor i Atdheut”. Historia labe dhe jo vetëm flet qartë për trimërinë dhe lavdinë e burrërisë shqiptare, për heronjtë e dëshmorët që gjakun e dhanë me vullnet të lirë për shenjtërinë e Atdheut dhe kombit. Refreni i këngës tingëllon fuqishëm edhe aktualisht: “Nëna ju kish rritur,/për një botë të re,/lule more trima,/që ratë për atdhe”. Rrëzoma dhe Krahina e Kardhiqit shekujve kanë qenë si një shtëpi me dy porta që për kullm kishin qafën e Skërficës, një qafë që shekujve përbashkonte zemrat ashtu sikurse sot rruga dhe tuneli i ka bërë njësh sup-bashkuar në luftëra dhe në halle, të bashkuar në zemra e në lidhje të shumta shpirtërore. Këtu në Senicë përbri rrugës së re pritët që të marrë jetë një projekt i dy dekadave më parë, më 4 prill 2004, kur një grup intelektualësh krijuan Shoqatën “Fushëbardha”, por që e firmosur ligjërisht në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Delvinës që mban nr.14 datë 30.3.2021, “Për miratimin e Propozimit për ngritjen e memorialit për 5 dëshmorë të LANÇ-it, pasi gjaku nuk bëhet ujë. Që prej 80 viteve flakadani i atdhetarisë në truallin e Fushëbardhës, krahinave Kardhiq e Rrëzomë, Delvinës, Labërisë, gjithë Shqipërisë ka qenë i ndezur dhe prushi i patriotizmit gjithmonë i nxehtë. Nuk ka dëshmi më të madhe e më solide se gjaku për atdhe, për kombin, për lirinë. Ishin pesë dëshmorë që ranë në një copëz toke Arbënore në shkurtmarsin e vitit 1944, atje pranë Senicës historike të kuvendeve, nderit dhe lavdisë, të mençurisë dhe punës, të pushkës dhe të diturisë, të punës dhe ardhmërisë. Pluhuri i harresës nuk mund të mbulojë dhe as të fshihet nga kujtesa e kombit shqiptar, ajo lavdi që u shkrua me gjakun e dëshmorëve. Prandaj liria i ka rrënjët thellë në gjakun e të rënëve. Për këtë arsye poeti qartëson: “...duhet të ngrenë nga balta e të rivrasin të rënë”. Memoria e kombit shqiptar për të rënë është çimentuar me gjakun e të rënëve nuk matet as me numra e as me kile, “as me okë e as me kokë”. Gjaku është shpagimtari më solemni i lirisë, themeli i së vërtetës, ideali i trupëzuar në panteonin e jetës prandaj burrat që i dolën zot vatanit meritojnë vetëm nderim. Pesë dëshmorët do jenë roje të lirisë së tokës arbërore, buzë rrugës së re Kardhiq - Delvinë. Ata do të trupëzohen njësh me tokën e gurtë, por dhe të sertë, shpirtërisht të lidhur besa-besë si një gjerdan në kalanë natyrore, por edhe përjetësisht në memorien e brezave. Aktet e mëdha njerëzore i japin kuptim historisë së mbijetesës, për të ruajtur dhe zhvilluar identitetin kombëtar, për të përjetësuar sakrificat e mëdha për liri dhe mëvetësi, që është historia e vërtetë e këtij kombi, është historia e dëshmorëve. Fakt është se më mirë, më drejtë, më bindshëm flet gjaku i dëshmorëve të Labërisë, flet historia për trimat Sami Golemi e Karafil Bello nga Fushëbardha, Hasan Çerepi nga Zhulati, Sefer Meta nga Golemi, Skënder Pepiaj nga Progonati, që ranë pranë Senicës së Delvinës, do të vijojë të flasë.

Sami Sejdi Golemi, me pushkë në dorë për lirinë e Atdheut

Sami Sejdi Golemi, ishte lindur më 15.7.1907 në Fushëbardhë të Gjirokastrës. Ai rridhte nga një familje me ndjenja e kontribute

SAMI GOLEMI I FUSHËBARDHËS: “BESËN PËR LIRINË, GJAKUN PËR ATDHEUN”



patriotike e atdhetare me emër të nderuar në Fushëbardhë dhe në krahinën e Kardhiqit. Fshati i tij i lindjes Fushëbardha është kodrinor e malor, mes malesh, në lagjen e Goleme, ku dimri vjen shpejt dhe ikën vonë, ku pranvera dhe vera ia lënë vendin njëra-tjetrës pa shumë ndryshime, veç plot lule e freski në behar dhe shumë dëborë e acar në dimrin e gjatë. Jeta e detyroi që të përballej herët me vështirësitë në fushë e në mal, duke e kapërcyer Qafën e Skërficës ditën e natën në borë e suferinë. Përfundoi shkollën fillore, por vuajtjet dhe hallet e kohës e mësuan të dallonte të mirën nga e keqja, padrejtësinë nga e drejta dhe kjo shpesh e revoltonte djalin e ri fushëbardhiot. Familja e tij ishte një familje e madhe. Babai i tij Sejdiu dhe nëna Nefize kishin tetë djem dhe dy vajza. Fisi i tij, Golemi ishin njerëz punëtorë, të thjeshtë, të dashur e të respektueshëm në fshat e krahinë, kishin shumë miq në krahinat e Kardhiqit dhe Rrëzomës por edhe deri në Përmet, Korçë, Ersekë, Himarë, Delvinë, Zonën e Konispolit e Çamërisë, në Vlorë e Mallakastër. Ishin njerëz zemërbardhë e mikpritës siç i thonë në Labëri, janë familje bukëdhënë, që rrezatonin mirësi. Familja përjetoi siç thotë populli “të zezat e ullirit” veçanërisht në përballien me andartët grekë më 1913-1914. Viti 1914 shënon edhe dramën e ndarjes forcërisht nga gjiri i familjes së trungut të shtëpisë, babait të tij Sejdiut, i cili u rrëmbye dhe u dërgua në ishullin e Korfuzit me anijen dragaminë me gjithë gjënë e gjallë. E megjithatë familja e tij mbijetoi. Vëllai i madh i Samiut, Kasëm Golemi mbajti vëllazërinë të përbashkuar si dhe në Luftën e Vlorës në 1920 ishte luftëtar me çetën e Fushëbardhës e Zhulatit dhe që kishte luftuar bashkë me Selam Musa Salarinë. Ai ka qenë anëtar i Këshillit Krahinor të krahinës së Kardhiqit deri në çlirimin e vendit. Samiu i doli zot vetes në Fushëbardhë, u burrërua para kohe dhe pas shkollës punuar në bujqësi, por të shquar në blegtori, në traditën e Sinanaliajve/Goleme. Në periudhën 15.7.1927 deri 15.7.1929, kreu shërbimin ushtarak në Ushtrinë Kombëtare, në regjimentin e Gjirokastrës, me disa bashkëmoshatarë të tij. Kjo ishte periudha e “pjekjes së djelmoshave” dhe që ishte detyrë ndaj shtetit bazuar në Ligjin ushtarak “Mbi Rregullimin e Ushtrisë Kombëtare”, një ushtri me 700 oficerë, 800 nënoficerë, 7800 ushtarë, që harxhonte deri në gjysmën e buxhetit të shtetit, por që nuk ishte e gatshme ta mbronte realisht vendin. Pas ushtrie Samiu më i rritur dhe i pjekur gjykonte thellë problemet e kohës, mbante pranë vetes dhe i mësonte nipçet e tij si Feron, Fejzon etj., me ta kalonte në fushat e në malet e Fushëbardhës, të Çajupit, të Malit të Gjerë, të Delvinës e deri në Bureto. Duke parë shtypjen dhe shfrytëzimin, e urreu regjimin shtypës dhe barbar të Italisë fashiste që erdhi më 7 prill 1939. Më 12 dhjetor 1942 formohet çeta “Çerçiz Topulli” në Fushëbardhë ku, që me themelimin e saj ishte dhe Sami Golemi me bashkëmoshatarë të tij të tjerë. Ai përjetonte një rizgjim të ri të burrërisë shqiptare, kur komandant ishte Dilaver Poçi, komisar Siri Çarçani, zv/komisar Gani Haloçi dhe intendent Mitat Kondi. Çeta “Çerçiz Topulli” e formuar në Fushëbardhë ishte

një ndër 288 çeta, që u krijuan gjatë LANÇ-it në të gjithë vendin. Çeta kishte në ditën e parë 27 partizanë që më vonë shkoi 40 partizanë, numër që erdhi gjithmonë në rritje. Sipas planit, çeta kaloi fillimisht në Vurg të Delvinës, ku u prit me dashuri nga populli. Më pas çeta kaloi në Dermish, ku shkatërroi Urën e Çakallos e më pas në Theollogo për asgjësimin e postave kufitare të armikut në Zminec, në Vërvë e Leshnicë. Materialet e postave kufitare të armikut u morën nga çeta partizane. Çeta kaloi gjithashtu edhe në fshatin Kulluricë, ku hapi depot e drithit dhe ua shpërndau fshatarëve të varfër, që bëri bujë të madhe për kohën. Në vitin 1943 çeta luftoi me italianët dhe bashkëpunëtorët e tyre në Vasjar të Tepelenës, më 11 dhe 12 qershor 1943, luftoi në Urën e Kardhiqit, në Humelicë dhe Cepo. Më 10 deri më 12 gusht 1943 çeta ku bënte pjesë Sami Golemi luftoi me milicët italianë. Në 30 dhe 31 gusht 1943 luftoi me garnizonin italian në Libohovë. Në shtator të vitit 1943 batalioni tek ura e Kardhiqit hyn në Gërhot pas kapitullimit të Italisë fashiste. Sami Golemi mori pjesë aktive në të gjitha veprimet luftarake në përbërje të formacioneve të çetave dhe batalioneve territoriale dhe të rinisë. Ai u bë luftëtar shumë aktiv, duke u gjendur në ballë në shumë aksione luftarake. Shokët e tij partizanë e njihnin Samiun me cilësitë më të mira, si trimërinë, zgjuarsinë, shkathtësinë dhe, për këto, ai gëzonte dashurinë dhe respektin e tyre. Një pjesë nga katër çetat e batalionit kaloi në batalionin territorial me komandant batalioni trimin Karafil Bello. Sami Golemi në batalionin territorial ishte skuadër komandant dhe me të njëjtën detyrë edhe në batalionin e rinisë. Në luftimet e Senicës së Rrëzomës tek bokërrima e kuqe, pranë qafës së Ujikut, bie heroikisht komandanti i batalionit territorial Karafil Bello në fillim të shkurtit 1944. Batalioni u riorganizua përsëri dhe në mes të marsit 1944 kalon në luftime në Senicë, Vergo, Kalasë me gjermanët si dhe bashkëpunëtorët e tyre. Pararoja bie në përpjekje dhe në këtë luftë vritet Sami Golemi, Sefer Meta, Skënder Pepiaj dhe Hasan Çerepi. Në të gjitha betejat tregoi guxim dhe trimëri të rrallë, gjaku i tij skuqi rrugët e gurta aq të njohura të Senicës, në përleshje fyt për fyt me fashistët gjermanë dhe tradhtarët. Ishte agjikator i LANÇ-it, duke shprehur urrejtjen ndaj okupatorit fashist italian dhe nazist gjerman, ku dhe ra, për të mos vdekur kurrë në luftën për çlirimin e Senicës, një fshat ngjitur me fshatin e tij të lindjes. Samiu ra në fushën e betejës duke lënë jetime vajzën njëvjeçare Gurien, pa e njohur vajzën e tij dhe ngeli dëshmor në përjetësinë e nderit të kombit. As vajza nuk e njohu dot babanë e saj, por njohu bashkëluftëtarët shokët e tij të armëve, njohu kujtimin dhe nderimin për përkushtimin heroik të babait dëshmor ndaj lirisë së Atdheut, respektin e brezave për këtë luftëtar të lirisë e kanë shoqëruar bijën e tij gjatë jetës. Ata i dolën zot Atdheut në kohë të vështira e rreziku, për lirinë dhe për të pasur shtet, prandaj nderohet e respektohet lufta e tyre, lufta e kombit shqiptar kundër nazizmit, fashizmit e bashkëpunëtorëve të tyre. Sami Golemi është shpallur “dëshmor i Atdheut” 27 vjet pas rënies me vendim nr. 65, datë 2 tetor 1971, të Komitetit Ekzekutiv të KP të Gjirokastrës. Kujtimi i Sami Golemi dhe dëshmorëve të tjerë, që dhanë jetën do jetë i përjetshëm. Treva labe dhe jo vetëm i ka nderuar dhe nderon në vijimësi brez pas brezi trimat, bijtë që kanë rënë në betejat e historisë për mbrojtjen e truallit arbëror. Ata ranë me armë në dorë për lirinë e Shqipërisë, prandaj dhe meritojnë nderimin në përjetësi. Memorial i munguar në dekada për djemtë dëshmorë, do shndërrohet në frymëzim brezash. Memoriali “Armëbashkuar për flamur” që do ngrihet në përkujtim të 80-vjetorit të rënies të pesë bijve të Labërisë nga Fushëbardha, Zhulati, Golemi, Progonati do të jetë vlera e çmuar e vend nderimit të shenjtëruar të lavdisë dhe krenarisë sikurse çdo komb i qytetëruar. Në bibliotekat tona nuk kanë munguar librat, enciklopeditë, monografitë, shkrime të shumta për historitë, artikuj të pafund, në Evropë e më gjerë që përkujtojnë të rënë për Atdhe. Europa është e mbushur me buste, lapidarë e memorialë, pllaka, rrugë, sheshe, shkolla, që mbajnë emrin e tyre. Nderimi dhe respekti për të rënë në trevën labe me memorialë në kuadrin e tetëdhjetë vjetorit të çlirimit të Atdheut, shpreh vlerësimin e idealeve të çlirimit, madhështinë e fitores dhe lirisë së Atdheut, si dhe devizën e përhershme kombëtare se, “kur bie për atdhe mbetet në pavdekësi”. Prandaj në pavdekësi do të mbeten dëshmorët e LANÇ-it: Hasan Salih Çerepi (1927-1944) 17 vjeç, Karafil Vehip Bello (1902-1944) 42 vjeç, Sami Sejdi Golemi (1907-1944) 37 vjeç, Sefer Ramo Meta (1916-1944) 28 vjeç, Skënder Mato Pepiaj (1925-1944) 19 vjeç, ku mosha mesatare ishte 28.6 vjeç. Memoriali i pritshëm për t’u ngritur do të mbushë një boshllëk për nderimin dhe mirënjohjen e munguar në tetë dekada për djemtë dëshmorë të cilët ranë me devizën: “Besën për lirinë, gjakun për Atdheun”.

27 vjetori i rënies në krye të detyrës së dëshmorit të atdheut kapiten i parë (I) Nuredin Gorçe.

“Çdo gjë për atdhe Komando jemi ne”, kjo është motoja që ka udhëhequr “Komandot” shqiptare në të gjitha misionet dhe detyrat që kanë kryer anembanë vendit. Kapiten I Nuredin Gorçe, humbi jetën tragjikisht 27 vjet më parë, në vitin 1997, gjatë masave të marra në kuadër të mbrojtjes dhe sigurimit të Brigadës “Komando”, (njësi kjo në të cilën ai shërbente në pozicionin e Shefit të Xhenios), nga sulmet e grupeve të armatosura.

Guximi dhe vendosmëria e Dëshmorit të Atdheut, kapiten I Nuredin Gorçe, për t’i qëndruar besnik betimit para flamurit, për të mbrojtur vendin nga çdo lloj kërcënimi dhe rreziku, qoftë edhe me jetën e tij, ngelet edhe sot burim frymëzimi, jo vetëm për efektivat e batalionit “Komando”, ku ai shërbeu me krenari dhe vetëmohim, por edhe për të gjithë efektivat e Forcës Tokësore, të cilët sot përulen me nderim para veprës së tij.

“Komando” janë një emër i dashur nga i gjithë populli shqiptar, dhe kjo për misionin dhe peshën e madhe të detyrave që ata kanë kryer jo vetëm jashtë vendit, por edhe rolin e veçantë që ata kanë luajtur në ngjarjet mjaft të vështira në vitet e turbullta që ka kaluar Shqipëria.

Për çdo ushtarak, por edhe për çdo shqiptar ngjarjet e vështira të vitit 1997 kujtohen me mjaft dhimbje për faktin se destabiliteti politik i vendit dhe anarkia e krijuar kudo i vuri strukturat e FA-së në vështirësi të mëdha për të përmbushur detyrat e tyre. Kjo për faktin se vala e revoltës mbarë popullore, si rezultat i humbjes së të ardhurave në firmat piramidale, solli një tërmet dhe revoltë popullore, e cila e shoqëruar edhe me paaftësinë e strukturave politike, institucionale, por edhe ushtarake për të drejtuar dhe menaxhuar situatën e krijuar çoi në degradimin dhe përshkallëzimin e situatës deri hapjen e depove të armatimit, marrjen dhe shkatërrimin e arsenalit ushtarak të kohës. Pa dashur të bëj analogji dhe analizë së këtyre ngjarjeve, ajo që duhet të them si bashkëvuajtës i këtyre situatave është se zemërat e brendshme popullore ishte e aq e madhe dhe e drejtë, sa që asnjë ushtarak nuk mund të reagoonte ndaj turmës të dëshpëruar, të cilët kërkonin kursimet e tyre tashmë të humbura.

Brigada “Komando” e Zall-Herrit, e cila ishte krijuar në vitin 1995, si pasuese e strukturave të zbulimit tashmë me 6 batalionet e saj të dislokuara në qytete të ndryshme të vendit, si Shkodër, Përmet, Pogradec, Berat dhe 2 batalione në Zall-Herr Tiranë, ishin të angazhuara për të vendosur dhe ruajtur situatën e sigurisë tashmë të dalë jashtë kontrollit. Ishte një situatë e cila kishte precipituar në konfrontime fizike, armët kishin rënë në dorën e popullit, Reparti Zall-Herrit tashmë po haste vështirësi, sepse kishte dyndje të popullatës që kërkonin armë, por ata u përballën me vendosmërinë e oficerëve të patrembur, të cilët kishin vendosur të mbronin repartin, kështjellën e tyre të palëkundur të ruanin emrin e tyre të mirë, i cili ishte gdhendur në mendjen e çdo Shqiptari.

Mbrojtja e repartit është detyrë për çdo ushtarak, dhe do të ishte fatale të shkatërrohej kjo pasuri e ngritur me mund e djersë, rënia e kësaj strukture elitë do thoshte, se ushtria s’do kishte ringritje, emri “Komando” do të zbehej, vlerat që mbanin në këmbë këtë kolonë të fuqishme të FA-së do rrëzoheshin bashkë me atë fatalitet që sollën ngjarjet e zymta të 97-ës.

A e përmbysën “Komandot” misionin e tyre përballë këtyre ngjarjeve të vështira?

Brigada “Komando” është ndër njësitë e vetme të FA-së, e cila nuk u dëmtua gjatë trazirave të 97-ës, kjo falë vendosmërisë, përkushtimit dhe profesionalizmit të oficerëve, n/oficerëve dhe ushtarëve të kësaj njësie elitë, të cilët jo vetëm e mbrojtën garnizonin e tyre, por u bënë burim frymëzimi edhe për repartet e tjera, ku mund të shikonin sinjalet e shpresës për t’u ringritur dhe kryer misionin e tyre. Duke kujtuar me dhimbje këto ngjarje, por edhe duke qenë krenar për atë çfarë ne bëmë, jo vetëm për ruajtjen e repartit, por edhe rolin që patën “Komandot” më vonë në ruajtjen dhe sigurinë e objekteve të rëndësishme të vendit.

Është vështirë të sjellësh në vëmendje ngjare të tilla, si ato të Marsit të vitit 97-të, ku ne qëndruam me ditë dhe net të tëra edhe pse reparti i rrethuar nga turma njerëzish nga katër anë, të cilët të irrituar kërkonin hapjen e repartit nga ku të merrnin armët, duke na njollosur dhe vënë përpara historisë, e cila këtë gabim s’do na e falte kurrë. Të gjendur përballë vendosmërisë sonë, ligjit për ruajtjen e repartit, falë mbështetjes së gjithanshme të pjesës më të madhe të popullatës të fshatit Zall-Herr, turmat e irrituara u zmbarsën disa herë, duke bërë të pamundur rënien

Nuredin Gorçe, hero i pavdekësisë së “Komandove” shqiptare



GUXIMI DHE VENDOSMËRIA E DËSHMORIT TË ATDHEUT, KAPITEN I NUREDIN GORÇE, PËR T’I QËNDRUAR BESNIK BETIMIT PARA FLAMURIT, PËR TË MBROJTUR VENDIN NGA ÇDO LLOJ KËRCËNIMI DHE RREZIKU, QOFTË EDHE ME JETËN E TIJ, NGELET EDHE SOT BURIM FRYMËZIMI, JO VETËM PËR EFEKTIVAT E BATALIONIT “KOMANDO”, KU AI SHËRBEU ME KRENARI DHE VETËMOHIM, POR EDHE PËR TË GJITHË EFEKTIVAT E FORCËS TOKËSORE, TË CILËT SOT PËRULEN ME NDERIM PARA VEPRËS SË TIJ.

e këtij reparti elitë të quajtur “Komando”.

Mbrojtja e repartit na kushtoi shumë, ne humbëm heroin tonë të përkushtuar shefin e Xhenios, ushtarakun e nderuar Kapitenin I Nuredin Gorçe, Dëshmorin e Atdheut, i cili ra në krye të detyrës për të mbrojtur infrastrukturën ushtarake të repartit, duke e bërë këtë repart të pamposhtur, përballë çdo rreziku sado i vështirë që ishte. Ne krenohemi me këtë repart, jo vetëm se pikërisht në këto ngjarje djemtë e kësaj njësie e kanë treguar veten, por më pas ishte ky repart të cilit iu dha detyra të kryente sigurinë e objekteve të rëndësishme shtetërore, jo vetën në Tiranë, por anembanë vendit.

Emri “Komando” është lartësuar dhe vazhdon të lartësohet me misionet e tyre jashtë vendit, duke filluar nga Bosnje-Hercegovina, Afganistani, Iraku, Chad-i dhe së fundi në Kosovë, ku “Komandot” me disiplinën dhe profesionalizmin e tyre kanë shkëlqyer, duke mbajtur lart emrin e madh që kanë. Do doja të sillja në vëmendje të gjithë heronjtë e këtyre ngjarjeve, duke

filluar nga Komandanti i Brigadës kolonel Arben Çuko, kolonel Fatmir Lokaj, n/kol. Rexhep Bleta, major Vladimir Vladi, major Shaqir Koliçaj, major Hajri Zhukri, major Përparim Tota, major Lulzim Sefa, major Asqeri Çeta, major Aleko Çuli, major Vangelj Ndini, kapiten Liman Hoxha, kapiten Behar Mara, kapiten Fatmir Lleshi, kapiten Haki Dingu, kapiten Elidon Shehu, kapiten Altin Bundo, kapiten Ylli Prifti, kapiten Musa Hida, toger Julian Prenga, kapiten Flamur Melani, kapiten Petrit Baçe, kapiten Besnik Saliasi, n/oficerët Arjan Rasa, Lutfi Hoxha, Ramazan Xhepa, Astrit Hoxha e të tjerë, të cilët kanë meritat e tyre të veçanta që historia në memorien e saj do t’i përmendë, si heronjtë e heshtur, të cilët i bënë një shërbim të madh vendit të tyre. Ata të gjithë së bashku mblidhen çdo datë 20 mars për të kujtuar heroin e tyre të pavdekësisë kapitenin e parë Nuredin Gorçe.

N/kol. Behar Mara, ish-koleg protagonist i ngjarjeve të 97-ës



Pasditen e 24 marsit 1999, presidenti i 42-të i SHBA-ve, Bill Clinton, në momentin e fillimit të fushatës së sulmeve ajrore iu drejtua nga Shtëpia e Bardhë, kombit amerikan lidhur me këtë ngjarje.

Në fjalën e tij, atëkohë, Bill Clinton tha: “Bashkëkombas të mi! Në këtë moment trupat serbe po lëvizin nga një fshat tek tjetri, po bombardojnë vendbanimet civile dhe po djegin shtëpitë. Ne po shohim njerëz të pafajshëm, të përzënë me forcë nga shtëpitë e tyre, njerëz që me forcë janë vendosur para togave të pushkatimit dhe gjuajtur me plumba. Burrat janë ndarë nga familjet e tyre, prindërit dhe fëmijët bashkë, të vënë në rresht, janë gjuajtur me një herë me armë zjarri.

Kjo që po ndodh në Kosovë, nuk ka asgjë të ngjashme me luftën dhe me ligjet tradicionale të luftës; kjo është një luftë e padrejtë e kryer me të gjitha arsenalet ushtarake ndaj njerëzve të pafajshëm që nuk mund të mbrohen dhe kur ata dhe udhëheqësit duan vetëm paqe. Pra, bashkëkombas, të luftojmë që ta mbyllim këtë tragjedi, e cila për kombin tonë është një kërkesë morale. Misioni ynë është më se i qartë: të tregojmë se ne dhe NATO e kemi seriozisht, që t’u lëmë të kuptojnë atyre që kontrollojnë në Serbi sot (24 mars 1999) se është e domosdoshme të ndërrojnë rrugën, të ndalojnë këtë lloj ofensive të ndërmarrë, duke derdhur gjak kundër qytetarëve të Kosovës, ta ndalojmë atë me të gjitha format që duhet ndaluar, duke e dëmtuar seriozisht ushtrinë serbe që është kundër njerëzve të pafajshëm në Kosovë. Dhe nëse presidenti Milosheviç nuk i bindet paqes atëherë na takon ne, që duke përdorur forcën ushtarake, ta ndalim atë dhe atij t’i shpallim luftën. Në anën tjetër, Serbia dhe personalisht Milosheviçi nuk i kanë pranuar bisedimet për zgjidhjen paqësore e politike të çështjes së Kosovës. Milosheviçi, përveç sundimit ndaj shqiptarëve me një sistem të paparë, filloi edhe ofensivat dhe krimet e veta masive kundër popullit shqiptar: me vrasje dhe masakra masive, djegie, dëbim masiv të shqiptarëve nga Kosova dhe me spastrimin etnik të Kosovës... Bashkëkombas! Unë jam i bindur se rreziku për të hapur luftë dhe bërë diçka nga SHBA-të, nuk është aq i madh sa ç’ është rreziku të rrimë duarkryq dhe të mos bëjmë asgjë, që të nxjerrim nga ky rrezik njerëzit që nuk mund të mbrohen. Sikur, ne sot, së bashku me aleatët tanë, ta lëmë që kjo luftë e padrejtë të vazhdojë, atëherë, presidenti Milosheviç, do të inkurajohet nga hezitimi ynë duke e quajtur luftën e tij, si një drejtësi duke vrarë njerëzit në Kosovë.

Kështu që atij ne i lëmë dorë të lirë për të bërë më shumë masakra, dhe më shumë shpërngulje me forcë të qindra mijëra refugjatëve, të cilët presin vetëm mbrojtjen tonë. Tani, bindja jonë e fortë për gjithçka që po ndodh në Kosovë, është e vetmja shpresë e popullit të Kosovës. Populli i saj, megjithëse në Kosovë kanë vendin e tyre, nuk mund të jetojnë atje, prandaj na duhet ne të sigurojmë jetën e tyre dhe ata të mos kenë më frikë për jetën.

Në anën tjetër, Serbia dhe personalisht Milosheviçi nuk i kanë pranuar bisedimet për zgjidhjen paqësore e politike të çështjes së Kosovës. Milosheviçi, përveç sundimit ndaj shqiptarëve me një sistem të paparë, filloi edhe ofensivat dhe krimet e veta masive kundër popullit shqiptar, me vrasje dhe masakra masive, djegie, dëbim masiv të shqiptarëve nga Kosova dhe me spastrimin etnik të Kosovës...

23 mars 1999

Një ditë para bombardimeve mbi Serbi, dhe caqet ushtarake në Kosovë, liderët shqiptarët nga Kosova, përfshi këtu edhe Thaçin, e pranuan marrëveshjen në parim, u kthyen në shtëpi për t’ua treguar atë njerëzve të tyre dhe në mes të marsit udhëtuan për në Paris për të firmosur dokumentin e përfunduar. Serbët e bojkotuan ceremoninë, ndërkohë që 40 mijë trupa serbe ishin grumbulluar përreth Kosovës, dhe Millosheviçi përsëriti se ai nuk do të lejonte kurrë vendosjen e



25 vjet nga 24 marsi i 1999



trupave të huaja në tokën jugosllave.

Unë e dërgova Dik Hollbruk-un (Richard - “Dick” Holbrooke) për ta takuar atë për herë të fundit, por edhe Dik-u nuk mundi ta lëvizte nga vendi. Më 23 mars, pasi Hollbruk-u largohet nga Beogradi, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, me mbështetjen time të plotë, i kërkoi Gjeneralit Uesli Klark të fillonte sulmet ajrore.

Në të njëjtën ditë, me shumicë votash 58- 41 Senati votoi për të mbështetur këtë veprim. Në fillim të muajit Dhoma e Përfaqësuesve kishte votuar 219 me 191 për të mbështetur dërgimin e trupave amerikane në Kosovë në rast se nënshkruhej marrëveshja e paqes.

Mes Republikanëve të njohur që votuan në favor të këtij propozimi ishin edhe Dennis Hastert dhe Henri Hajd (shënim i im Henry Hyde, një mik i madh lobit shqiptarë, pikërisht ish-kongresist republikan të New Yorkut, Xhozef DioGuardit).

Ndërsa shumica e Kongresit dhe të gjithë aleatët tanë në NATO mbështesnin sulmet ajrore, Rusia nuk ishte në të njëjtën linjë. Kryeministri Yevgeni Primakov ishte duke udhëtuar drejt Shteteve të Bashkuara për t’u takuar me Al Gore. Kur Al e njoftoi se një sulm mbi Jugosllavinë ishte i mundshëm, Primakov urdhëroi që aeroplani i tij të kthehej mbrapsht drejt Moskës.

Më datën 24 (mars 1999) unë iu drejtova popullit amerikan për t’i treguar se çfarë isha duke bërë dhe arsyet pse po ndërmerrja një akt të tillë.

U shpjegova atyre se Millosheviçi u kishte zhvatur shqiptarëve nga Kosova autonominë, duke u mohuar të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë për të folur gjuhën e tyre, për të pasur shkollat e tyre dhe për t’u vetëqeverisur. Unë iu përshkrova atyre masakrat serbe: vrasjen e civilëve, djegien e fshatrave, dëbimin e njerëzve nga shtëpitë e tyre, 60 mijë vetëm në pesë javët e fundit dhe gjithsej një çerek milioni.

Më në fund unë kisha mundësi t’i vendosja ngjarjet aktuale në kontekstin e luftërave që Millosheviçi kishte shpallur kundër Bosnjës dhe Kroacisë dhe në ndikimin shkatërrues të vrasjeve të tij mbi të ardhmen e Europës.

Fushata e bombardimeve kishte tre qëllime: t’i tregonte Millosheviçit se ne e kishim seriozisht se do të ndalonim një radhë tjetër të spastrimit etnik, se do të shmangnim një sulm akoma më të përgjakshëm kundër civilëve të pafajshëm në Kosovë dhe se nëse Millosheviçi nuk do të dorëzohej së shpejti ne do të dëmtonim seriozisht kapacitetin ushtarak të Serbisë.

24 mars 1999, filluan sulmet ajrore

Ato do të zgjasnin për 11 javë, ndërkohë që Millosheviçi vazhdonte të vriste shqiptarët e Kosovës dhe të dëbonte rreth një milion shqiptarë prej shtëpive të tyre. Bombat do të shkaktonin dëme të mëdha mbi infrastrukturën ushtarake dhe ekonomike të Serbisë. Fatkeqësisht në disa raste ato do t’u shmangeshin koordinatave të përcaktuara dhe do të merrnin jetën e njerëzve që ne po përpiqeshim të mbronim.

Disa njerëz arsyetonin se qëndrimi ynë do të kishte qenë më i justifikuar nëse do të kishim dërguar edhe trupa ushtarake nga toka. Por me këtë argument kishte dy probleme. Së pari, derisa ushtarët të arrinin në pozicionet e tyre, të mjaftueshëm në numër dhe me mbështetjen e duhur, serbët do të shkaktonin një dëm shumë të madh. Së dyti, viktimat civile të një fushate ushtarake në tokë do të kishin qenë shumë herë më të mëdha sesa numri i viktimave si rezultat i bombave të pasakta.

Unë nuk u bashkova dot me argumentin se duhej të ndiqja një kurs, i cili do të merrte më shumë jetë amerikanësh, pa siguruar shumë bindshëm mundësinë e një fitoreje. Strategjia jonë shpesh do të dyshohej, por ajo kurrë nuk u braktis.

Më 24 mars 1999, NATO filloi bombardimin e trupave ushtarake dhe paramilitare të Serbisë. Bombardimet përfunduan, më 6 qershor 1999, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës, që parashihte tërheqjen e trupave jugosllave nga Kosova dhe vendosjen e trupave paqësore ndërkombëtare.

Më pas, Këshilli i Sigurimit i OKB-ës miratoi rezolutën 1244 me të cilën u vendos protektorati, prania ndërkombëtare në Kosovës, UNMIK-ut si mision civil dhe KFOR-it, mision ushtarak.

Më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë, e cila është e njohur deri tani nga 120 shtete përfshirë SHBA-të, Anglinë, Gjermaninë, Francën, Italinë, Holandën, Suedinë, Japoninë, etj.

Sëmundja X: Pandemia e radhës?

Sëmundja X, një term i mbuluar me mister dhe kujdes, nuk përfaqëson një sëmundje specifike, por një vendmbajtës për të papriturat, një pandemi e mundshme në të ardhmen që mund të tejkalojë sëmundjet e njohura në ndikim. I krijuar për herë të parë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), ky patogjen hipotetik simbolizon natyrën e paparashikueshme të kërcënimeve shëndetësore në një botë të lidhur globalisht. Është një kujtesë e ashpër e nevojës gjithmonë të pranishme për vigjilencë, kërkime dhe gatishmëri përballë kundërshtarëve të panjohur.

Çfarë është saktësisht sëmundja X?

Sëmundja X përfaqëson një patogjen hipotetik që mund të çojë në një pandemi globale. E krijuar nga OBSH, ajo simbolizon paparashikueshmërinë e kërcënimeve të ardhshme shëndetësore, duke nxitur gatishmërinë globale.

Kombet mbledhen kundër kërcënimit të padukshëm

Bashkëpunimi global është thelbësor në luftimin e sëmundjes X. Ky unitet përfshin ndarjen e kërkimeve, burimeve dhe strategjive, duke nënvizuar rëndësinë e veprimit kolektiv në krizat shëndetësore.

Shkencëtarët në garë me kohën

Shkencëtarët e përkushtuar janë në ballë, duke kryer kërkime për të kuptuar kërcënimet e mundshme si Sëmundja X. Puna e tyre është thelbësore në zhvillimin e mekanizmave të zbulimit të hershëm dhe reagimit.

Kuptimi i vigjilencës së OBSH-së

Lista e projekteve të OBSH-së përshkruan me përpikëri sëmundjet, përfshirë Sëmundjen X, që mund të shkaktojnë emergjenca globale. Është një udhëzues strategjik për priorizimin e kërkimit dhe shpërndarjes së burimeve.

Si modelet hartojnë rreziqet e padukshme

Modelimi parashikues luan një rol kyç në kuptimin e sëmundjes X. Duke analizuar të dhënat mbi patogenet e njohur, ekspertët mund të parashikojnë se si mund të shfaqen dhe përhapen sëmundje të reja.

Traktati i Pandemisë: një premtim global për gatishmëri

Një traktat i propozuar pandemik synon të forcojë përgjigjen globale ndaj sëmundjeve si Sëmundja X. Ai thekson bashkëpunimin, duke siguruar që vendet të jenë më të përgatitura për krizat e ardhshme shëndetësore.

Luftëtarët e vijës së parë

Punonjësit e kujdesit shëndetësor janë heronjtë e heshtur në betejën kundër epidemive. Gatishmëria dhe aftësia e tyre e reagimit janë jetike në menaxhimin e fazave fillestare të një shpërthimi si Sëmundja X.

Laboratorët udhëheqin çështjen

Laboratorët e kërkimit janë qendra inovacioni, vendimtare në luftën kundër Sëmundjes X. Janë aty ku bëhen zbulime novatore në diagnostikim, trajtime dhe vaksina.

Sëmundja X kundër SARS-COVID

Krahasimi i Sëmundjes X me SARS-COVID thekson rëndësinë e të mësuarit nga pandemitë e kaluara për të përmirësuar përgjigjet në të ardhmen. Është një kujtesë e nevojës së vazhdueshme për vigjilencë.

Kërkimi për mbrojtje universale

Vaksinat janë thelbësore për të luftuar viruset si Sëmundja X. Kërkimi për mbrojtje universale përfshin kërkime inovative dhe shpërndarje të barabartë për të mbrojtur shëndetin global.

Qendrat e transferimit të teknologjisë

Qendrat e transferimit të teknologjisë si ajo në Afrikën e Jugut janë shembulli i bashkëpunimit global. Ato lehtësojnë prodhimin lokal të vaksinave, duke siguruar përgjigje të shpejta dhe të barabarta ndaj kërcënimeve si Sëmundja X.

Barazia në kujdesin shëndetësor

Barazia është thelbësore në luftën kundër sëmundjes X. Sigurimi i aksesit të drejtë në burimet dhe trajtimet e kujdesit shëndetësor në të gjithë kombet forcon elasticitetin global ndaj pandemive.

Profilizimi i patogjenëve të mundshëm

Kuptimi i patogjenëve të mundshëm është çelësi në luftimin e sëmundjes X. Kërkimi në familjet e viruseve dhe sjelljet e tyre ndihmon në zhvillimin e strategjive të parandalimit dhe trajtimit të synuar.

Roli i komunitetit në kohë krize

Komunitetet luajnë një rol kyç në menaxhimin e krizave. Ndërgjegjësimi i publikut dhe respektimi i udhëzimeve shëndetësore mund të frenojnë ndjeshëm përhapjen e sëmundjeve si Sëmundja X.

Parashikimi dhe parandalimi i shpërthimeve

Modelet e avancuara parashikojnë shpërthime të mundshme, duke udhëhequr masat proaktive. Kjo largpamësi është e dobishme në përgatitjen për Sëmundjen X, nga grumbullimi i furnizimeve deri te zhvillimi i planeve të reagimit, i cili është një fokus kryesor në dritën e pandemisë së fundit.

Si mund të shfaqej sëmundja X

Sëmundja X mund të shfaqet në heshtje, nga transmetimi nga kafsha te njeriu ose mutacione të pavërejtura. Vigjilenca në monitorim dhe zbulimi i hershëm janë jetike për të parandaluar shpërthimet e përhapura.

Mësimet e COVID për të ardhmen

Mësimet nga COVID-19 janë të paçmueshme në trajtimin e sëmundjes X. Ato nënvizojnë rëndësinë e bashkëpunimit global,



reagimit të shpejtë dhe përshtatjes së vazhdueshme të strategjive shëndetësore.

Urgjenca e zbulimit të hershëm

Zbulimi i hershëm është thelbësor në menaxhimin e sëmundjes X. Mekanizmat e reagimit të shpejtë, nga gjurmimi i kontakteve te protokollet e karantinës, mund të zbusin ndjeshëm ndikimin e shpërthimeve.

Kryqëzimi i shëndetit dhe politikës

Politikat luajnë një rol kritik në menaxhimin e krizave. Përgjigjet e politikave të koordinuara sigurojnë që sistemet shëndetësore të jenë të fuqishme dhe të gatshme për t'u përballur me sfidat e paraqitura nga Sëmundja X.

Përpjekjet bashkëpunuese në kërkime

Bashkëpunimi përshejton përpërimin në luftimin e sëmundjes X. Partneritetet midis kombeve, institucioneve dhe studiuesve nxisin risitë në kuptimin dhe trajtimin e sëmundjes.

Ndikimi global i shpërthimeve lokale

Shpërthimet lokale mund të përshkallëzohen në kërcënime globale. Përgjigjet e shpejta dhe të koordinuara ndërkombëtare janë thelbësore për të përmbajtur sëmundje si Sëmundja X, duke kapërcyer kufijtë gjeografikë.

Adresimi i pabarazisë në përgjigjen ndaj sëmundjes

Pabarazia në përgjigjen ndaj sëmundjeve mund të përkeqësojë krizat globale. Kapërcimi i këtij hendeku siguron që të gjitha rajonet, të pasura apo të varfra, të jenë njëlojtë të përgatitur për të trajtuar kërcënime si Sëmundja X.

Histori nga vija e frontit

Historitë e punëtorëve të vijës së parë theksojnë qëndrueshmërinë dhe përkushtimin njerëzor. Përvojat e tyre ofrojnë njohuri të paçmueshme në betejën kundër pandemive dhe janë pjesë e masave

parandaluese për të gjitha sëmundjet, përfshirë Sëmundjen X.

Ndërtimi i një sistemi të fortë të kujdesit shëndetësor

Një sistem i fuqishëm i kujdesit shëndetësor është mbrojtja jonë më e mirë kundër sëmundjes X. Investimi në infrastrukturën e kujdesit shëndetësor dhe trajnimi i fuqisë punëtore siguron gatishmëri për çdo emergjencë shëndetësore.

Gara për një kurë

Studiuesit në mbarë botën janë në një garë për të gjetur kura për kërcënimet e afërta si Sëmundja X. Kërkimi i tyre i pashtershëm për njohuri ushqen shpresën për zbulime dhe zgjidhje të ardhshme.

Financimi i luftës kundër sëmundjes X

Financimi adekuat është thelbësor në luftën kundër sëmundjes X. Investimi në kërkime, infrastrukturën e kujdesit shëndetësor dhe reagimin ndaj urgjencës mund të zbusë ndjeshëm ndikimin e pandemisë.

Kuptimi i shpejtësisë së përhapjes

Shpejtësia me të cilën përhapet një sëmundje është thelbësore për strategjitë e kontrollit. Kuptimi i shpejtësisë virale ndihmon në hartimin e përgjigjeve efektive për të kufizuar përhapjen e Sëmundjes X.

Lundrimi në parandalimin e sëmundjeve në mbarë botën

Kuptimi kulturor është kyç në parandalimin dhe menaxhimin e sëmundjeve. Përshtatja e mesazheve dhe ndërhyrjeve shëndetësore për t'u përshtatur konteksteve kulturore mund të përmirësojë luftën kundër të gjitha sëmundjeve.

Përqafimi i një të ardhmeje të armatosur me njohuri

Ndërsa parashikojmë një të ardhme me Sëmundjen X, armatosja me njohuri, gatishmëri dhe unitet është strategjia jonë më e mirë. Së bashku, ne mund t'i kthejmë sfidat në mundësi për elasticitet.



Shkencëtarët kinezë krijojnë dronë që mund të shumëzohen me shpejtësi në ajër për të krijuar një goditje taktike

Shkencëtarët kinezë thonë se kanë zhvilluar një lloj të ri të dronit luftarak, i ndryshëm nga çdo lloj i parë ndonjëherë në fushën e betejës. Sapo kjo pajisje e re të arrijë hapësirën ajrore të synuar, ajo mund të ndahet sa hap e mbyll sytë në dy, tre apo edhe gjashtë dronë më të vegjël, në varësi të nevojave të betejës.

Në pamje të parë, ai i ngjan një multirotori kinez DJI të shkallës së konsumatorit. Megjithatë, pasi të arrijë hapësirën ajrore të synuar, mund të ndahet sa hap e mbyll sytë në dy, tre apo edhe gjashtë dronë më të vegjël, në varësi të asaj që nevojitet në betejë.

Secili prej këtyre dronëve ka vetëm një teh, por mund të rrijë pezull dhe të lëvizë lirshëm si një dron i zakonshëm. Ata mund të komunikojnë me njëri-tjetrin dhe secili mund të luajë një rol të veçantë - si komanda, zbulimi, gjurmimi dhe madje nisjen e një sulmi - ndërsa bashkëpunojnë për të përfunduar një mision.

Hulumtimi, i udhëhequr nga profesori Shi Zhiwei nga Universiteti i Aeronautikës dhe Astronautikës në Nanjing, është një përparim në teknologjinë e ndarjes në ajër.

Për vite me radhë, ekipet në mbarë botën janë përpjekur të krijojnë një metodë praktike dhe efikase për ndarjen e kontrolluar të dronëve në ajër.

Teknologjia mund të ndryshojë fushën e betejës. Kur një tufë dronësh shfaqet në ekranet e radarëve të armikut, sistemet e mbrojtjes ajrore ndajnë burimet dhe mjetet e armëve kundër dronëve bazuar në numrin e dronëve.

Sidoqoftë, nëse tufa e dronëve rritet papritur në madhësi, jo vetëm që sistemi i mbrojtjes do të mbingarkohet, por ai paraqet një goditje psikologjike që mund të pengojë rezistencën efektive nga komandantët dhe ushtarët e armikut.

Progresi në këtë teknologji ka qenë i ngadaltë sepse efikasiteti i fluturimit është ulur ndjeshëm kur kombinohen dronët tradicionalë.

Në një punim të rishikuar të botuar në revistën “Acta Aeronautica et Astronautica Sinica”, ekipi i Shi tha se e kishte kapërcyer këtë sfidë. Kombinimi i dronëve, tha ai, mburrej me një efikasitet fluturimi gati dy herë më shumë se një dron me shumë rrotullues me madhësi të ngjashme.

Kur këta dronë të vegjël u bashkuan, ata mund të fluturonin më shpejt dhe më larg se sa mund ta bëjë vetëm. Edhe pas ndarjes, efikasiteti i tyre i fluturimit mbeti më shumë se 40 për qind më i lartë se ai i dronëve të vegjël tradicionalë - demonstrimi i parë që dronët e kombinuar mund të tejkalojnë dronët e vetëm në çdo gjendje fluturimi.

Kina është projektuesi dhe prodhuesi kryesor në botë i dronëve, duke treguar çmime të shkëlqyera dhe efikasitet të energjisë. Megjithatë, “dizajni i kombinuar dhe teknologjia e ndarjes e ajrit ofrojnë mundësinë për të rritur më tej efektivitetin e përdorimit të dronëve”, - shkruan Shi dhe kolegët e tij.

Frymëzimi për ekipin e Shi erdhi nga një burim i paimagjinueshëm: fara e panjave. E admiruar prej kohësh nga botanistët për aftësinë e saj për t’u bartur në distanca të mëdha nga era, struktura unike e farës së panjave - një kotiledon i ngjashëm me krahët që rrotullohet rreth farës - siguron ngritje dhe e lejon atë të rri pezull apo edhe të ngjitet në kushte me erë.

Droni i ri hipersonik i Kinës mund F-22-shin në efikasitetin aerodinamik

Në vitin 2012, studiuesit në “Lockheed Martin”, prodhues kryesor i armëve në SHBA, morën frymëzim nga fara e panjave për të zhvilluar një dron me një lente vazhdimisht rrotulluese të aftë për gjurmim të qëndrueshëm të objektivit dhe imazhe me definicion të lartë.

Megjithatë, i kufizuar nga energjia dhe kapaciteti i ngarkesës së tij, ai nuk mund të fluturonte për periudha të gjata ose të merrej vetëm me detyra komplekse. Ekipi amerikan parashikoi aeroplanë të mëdhenj që do t’i dërgonin këta dronë, por kostoja dhe rreziku për t’u rrëzuar rezultuan të ndaluara.

Ndërsa ekipet e tjera perëndimore kanë zhvilluar që atëherë makina të ngjashme, asnjë nuk ka raportuar aplikime praktike në shkallë të gjerë.

Ekipi i Shi thotë se dronët e frymëzuar nga farat e panjave mund të merren nga laboratorit në linjat e prodhimit në Kinë për të revolucionarizuar luftën e ardhshme. Megjithatë, çelësi është t’i montoni ato për të arritur një fluturim efikas në distanca të gjata.

Për këtë qëllim dhe pas dështimeve të shumta, ata kryen teste të gjera dhe të detajuara të tunelit të erës dhe më në fund



gjetën një formë tehu që mbështeste efikasitetin e fluturimit të kombinuar dhe fluturimit të vetëm.

Bashkimi i disa dronëve me një tehe prezanton një grup të veçantë karakteristikash fizike dhe logjike të kontrollit të fluturimit, duke u larguar rrënjësisht nga modelet e njohura me shumë rotorë. Prandaj, ekipit iu desh të ndërtonte një model fizik pothuajse nga e para dhe të krijonte një softuer unik të kontrollit të fluturimit.

Komunikimi me shpejtësi të lartë midis dronëve të vegjël është gjithashtu një sfidë, sipas Shi.

Në testet e fluturimit, si trupi i kombinuar ashtu edhe dronët individualë ishin të qëndrueshëm. Megjithëse shpejtësia maksimale e fluturimit të trupit të kombinuar nuk mund të përputhej me atë të disa dronëve ushtarakë me performancë të lartë, ai mund të lëshonte dronë të vegjël, sapo të arrinte hapësirën ajrore të synuar, aq shpejt sa kundërshtari mund të mos kishte as kohë për të përcaktuar se çfarë po ndodhte.

Shkencëtarët thanë se një ushtar mund të mbante disa module të tilla dhe të grumbullonte funksione dhe sasi të ndryshme dronësh në vend për të përfunduar misionet sipas nevojës, duke i dhënë ushtrisë një avantazh më të madh taktik ndaj kundërshtarëve të saj.

Si përdor Ukraina dron vdekjeprurës detar për të synuar flotën ruse të Detit të Zi

Që nga fillimi i luftës Rusi-Ukrainë, Kina ka dyfishuar përpjekjet e saj për kërkimin dhe prodhimin e dronëve, duke u përpjekur për përparime teknologjike dhe efektivitet të pashembullt të koston për të qenë gati për konfliktet e ardhshme.

Megjithatë, disa ekspertë ushtarakë paralajmërojnë se sistemet e dronëve të Kinës mbeten të patestuara në luftëra në shkallë të gjerë, duke hedhur një hije mbi efikasitetin e

strategjisë.

Varkat pa ekuipazh dhe me telekomandë kanë ekzistuar që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore. Në fund të shekullit të kaluar, risitë teknologjike zgjeruan përdorimet e tyre të mundshme.

Dronët vdekjeprurës dhe të avancuar detar të zhvilluar dhe vendosur nga Ukraina në luftën e saj me Rusinë kanë hapur një kapitull të ri në histori.

Dronët e marinës ukrainase sulmuan anijen patrulluese “Sergei Kotov” pranë ngushticës Kerç, e cila lidh Detin e Zi dhe Detin Azov, sipas agjencisë së inteligjencës ushtarake të Ukrainës.

Sulmi, i cili nuk mund të verifikohet në mënyrë të pavarur, vrau shtatë anëtarë të ekuipazhit rus dhe plagosi gjashtë të tjerë, ndërsa 52 u shpëtuan, tha agjencia.

Ministria ruse e Mbrojtjes nuk e komentoi pretendimin, por disa blogerë ushtarakë rusë konfirmuan humbjen e anijes dhe thanë se ekuipazhi i saj ishte shpëtuar.

Sulmi, nëse verifikohet, do të shënonte përdorimin e fundit të suksesshëm të dronëve të prodhimit vendas të Ukrainës “Magura”, anijet e shkathëta pa ekuipazh që janë bërë armiku i marinës ruse.

Vetëm muajin e kaluar, dronët fundosën anijen zbarkuese amfibe ruse “Caesar Kunikov” dhe korvetën e raketave “Ivanovets”.

Ushtria ruse nuk i ka pranuar as ato humbje, por ato janë raportuar nga blogerët ushtarakë rusë dhe disa media.

Ukraina pretendon se është vendi i parë që ka ngritur një njësi specifike të dedikuar për prodhimin e dronëve në det. Houthitë me bazë në Jemen kanë vendosur gjithashtu anije sipërfaqësore të armatosura pa pilot si varka me dronë vetëvrasës që shpërthejnë pas përplasjes.



Ronald Reagan: Zoti Gorbaçov, shembeni këtë mur!

Fjalim i mbajtur në Berlinin Perëndimor, në mbështetje të parimeve demokratike, më 12 qershor 1987

Një faktor mirëkuptimi e karakterizonte presidencën e Ronald Reganit, që ishte përruruar më 21 janar 1981. Natyra e tij rrëzëlluese përhapte një besim qetësues, njohuritë e tij të sakta mbi botën përhapnin siguri dhe humori i tij vetëshpotitës e lidhte me amerikanët e thjeshtë. Ndërsa Niksoni dukej se mishëronte mundimet e të qenit president dhe Xhimi Karter mishëronte paaftësinë për t'i kthyer parimet në vepra, Regani e bëri presidencën të ngjante si një punë argëtimi. Një nga replikat e tij më të goditura ishte: “Është e vërtetë që nuk ka vdekur njeri nga puna e rëndë. Por pse të rrezikosh?”. Jo më kot Regani njihej si “Komunikuesi i Madh” dhe platforma e tij e taksave më të ulëta, e qeverisë më të vogël, e vlerave të vendlindjes, e financave të balancuara dhe e një buxheti ushtarak të majmë, i bënë të ashtuquajturit “Demokratë të Reganit” të ndërrojnë bindje dhe të mblidhen rreth tij.

Karriera e parë e Reganit ishte ajo e aktorit kinematografik dhe televiziv, ndaj dhe fjalimet e tij politike ishin gjithmonë pa asnjë të metë. Ai do ta udhëzonte hartuesen e fjalimeve të tij, Peggy Nooan, duke i bërë të qartë se ç’ dëshironte të thoshte dhe ajo ia hartonte fjalimet në përshtatje me stilin e tij të thjeshtë. Kritikët e tij do të citonin shpesh të kaluarën e tij prej aktori, duke e parë presidencën e tij si një triumf të paraqitjes ndaj përmbajtjes. Por ka një pikë në të cilën bashkohen si kritikët ashtu dhe admiruesit e tij: Regani qe një lider që u delegonte mjaft pushtet vartësve të vet, dhe po ashtu qe njeri që karakterizohej nga bindje të palëkundura e jetëgjata, mbi të cilat u mbështet politika e Shtëpisë së Bardhë.

Askund nuk ishte më e qartë kjo sesa në qëndrimin që ai mbajti ndaj Bashkimit Sovjetik, të cilin, duke braktisur gjuhën e detantës, ai e quajti “perandoria e së keqes”. Liberalët e përqeshën gjuhën e tij prej libri komik, por ajo pasqyronte besimin e tij në imoralitetin që qëndronte në themel të sistemit.

RONALD REGAN

Lindur më 6 shkurt 1911, në Tampiko, Illinois. Nisi si spiker i emisioneve sportive në radio dhe nga viti 1937, punoi si aktor me kontratë me studion kinematografike “Warner Brothers”, ku gjatë karrierës së tij luajti në 53 filma.

Në vitin 1950, ai u bë guvernator i Kalifornisë. Vdiq më 5 qershor 2004, në Los Anxheles. Vitet e fundit të jetës së Reganit ishin të mjegulluara nga sëmundja e Alzhajmerit. Edhe pse ditët e fjalimeve tanimë kishin marrë fund, “Komunikuesi i Madh” e la përsëri një lamtumirë elokuede, por këtë herë vetëm të shtypur: “Unë tani po nis udhëtimin, që do të më shpjerë në perëndimin e jetës sime”.

Në qershor të vitit 1987, Regani u shfaq përpara Portës së Brandeburgut Berlin, qytetit emblematic të Luftës së Ftohtë, sikurse kishin bërë përpara tij presidentët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Për të mbajtur një fjalim. Ai vuri në dukje kontrastin midis begatisë, pasurisë kulturore dhe lirisë që kishin kultivuar banorët e Berlinit Perëndimor qysh nga viti 1945, me “prapambetjen” e botës totalitare përtej Murit të Berlinit, një botë që, sikundër e përshkroi ai: “i bën një dhunim të tillë shpirtit”. Por Regani kishte gjithashtu dhe një program, i cili përmbledhje në kërkesën e tij: “Sekretari i Përgjithshëm Gorbaçov... nëse ju kërkon liberalizim... shembeni këtë mur!”. Nga njëra anë, kjo ishte pjesë e dukshme e retorikës politike. Por kohët po ndryshonin me shpejtësi, sepse tani në krye të Bashkimit Sovjetik, ishte një reformator, Mikhail Gorbaçovi, një njeri me të cilin Regani nënshkroi po atë vit traktatin e pakësimit të raketave.

Regani e parashikoi se ky mur do të bjerë. Sepse ai nuk mund t'i bëjë ballë besimit, ai nuk mund t'i bëjë ballë të vërtetës. Dy vjet më pas, Muri i Berlinit Vërtet u rrëzua. Historianët mund të debatojnë se deri në ç’ masë kontribuoi presidenca e Reganit për t'i dhënë fund Luftës së Ftohtë.

Njëzet e katër vjet më parë Presidenti Xhon F. Kennedy vizitoi Berlinin dhe i foli popullit të këtij qyteti e mbarë botës nga Bashkia e Berlinit Perëndimor. Dhe qysh atëherë kanë ardhur njëri pas tjetrit në Berlin edhe dy presidentë të tjerë amerikanë. Sot unë po bëj vizitën time të dytë në qytetin tuaj. Ne presidentët amerikanë vijmë në Berlin, sepse është detyra jonë të flasim për lirinë në këtë vend. Por më duhet ta pranoj që ne vijmë në këtë vend edhe për arsye të tjera, ne na sjell këtu ndjenja e historisë që ndihet në këtë qytet, 500 vjet më të vjetër se kombi ynë, bukuria që kanë Grunetvald-i dhe Tiergarten-i, por mbi të gjitha vendosmëria juaj.

Ndoshta kompozitori Paul Lincke kuptoi diçka nga guximi i presidentit amerikan. Ju e shihni që, si shumë presidentë amerikanë



përpara meje, unë erdha sot këtu sepse kudo që shkoj e çfarëdo që bëj, “Ich habnoch einen Koffer in Berlin” - unë e kam ende një valixhe në Berlin.

Prapa meje qëndron një mur, që rrethon sektorët e lirë të këtij qyteti, një mur që është pjesë e një sistemi të gjerë barrierash që ndajnë të gjithë kontinentin e Europës. Që nga Baltiku e deri në jug, këto barriera e përshkojnë Gjermaninë me gjerdhjet e telave me gjemba e me mure prej betoni, me qen kufiri e kulla vrojtimi. Më larg, në jug, këto gjerdhe mbase nuk janë të dukshme, mbase nuk ka mure të vërtetë, Por mbeten përsëri rojet e armatosura dhe pikat e kontrollit me të njëjtat roje të armatosura, që kufizojnë po aq të drejtën e udhëtimit e që përbëjnë përsëri një instrument për t'u imponuar të gjithë njerëzve të thjeshtë vullnetin e një shteti totalitar. Megjithatë, është këtu në Berlin që ngrihen më të dukshme se kudo këto mure. Këtu, duke përshkuar tejpertej qytetin tuaj e nëpërmjet fotolajmeve dhe ekranit të televizionit, këto mure kanë ngulitur në mendjen e mbarë botës këtë ndarje brutale të një kontinenti. Duke qëndruar përpara Portës së Brandenburgut, çdo njeri e ndien veten një gjerman të ndarë nga njerëzit e gjakut të tij. Këtu çdo njeri është një berlinez i detyruar të vështrojë mbi një dregëz plage.

Aty ku katër dekada më parë ishte një gurishte, sot në Berlinin Perëndimor shtrihet zona më e madhe industriale që ka ndonjë qytet në Gjermani - shtrihen blloqe të tërë me zyra të zëna me punë, shtëpi dhe apartamente të bukura, shëtitore krenare dhe lëndina të gjera të parqeve. Aty ku dukej se kultura e qytetit që shkatërruar, sot ka dy universitete të mëdhenj, ka orkestra dhe një opera, ka teatro dhe muzeume të panumërt. Aty ku kishte skamje, sot ka begati në ushqime, në veshje e në automobila, të mirat materiale të mrekullueshme të Ku’damm-if. Nga shkatërrimi e nga gërmadhat ju berlinezët, në liri, keni ndërtuar një qytet që renditet përsëri si një nga më të mëdhenjtë e botës. Sovjetikët mund të kenë pasur plane të tjera. Por, miqtë e mi, kishte ca gjëra që sovjetikët nuk i llogaritën: ‘Berliner Herz, Berliner Humor, ja, und Berliner Schnauze’ - zemrën berlineze, humorin berlinez, PO, dhe “berliner Schnauze”.

“Edhe sovjetikët vetë mund... të arrijnë ta kuptojnë rëndësinë e lirisë”

Në vitet 1950, Hrushovi parashikonte: “Ne do t’ju varrosim juve”. Por perëndimi që ne shohim sot është një botë e lirë që ka arritur një nivel begatie dhe mirëqenieje të paparë në tërë historinë njerëzore. Në botën komuniste, ne shohim dështime, prapambetje teknologjike, rënien e standardeve të shëndetit e madje dhe mungesën e gjërave më themelore deri tek ai pak ushqim sa për të mbajtur frymën gjallë. Edhe sot Bashkimi Sovjetik nuk arrin ende të ushqejë veten e vet. Pas këtyre katër dekadave, përpara gjithë botës ka dalë në shesh një përfundim i madh e i pashmangshëm: “Liria shpie në begati. Liria i zëvendëson me mirësjellje dhe me paqe urrejtjet e vjetra”.

“Liria është fitimtare”

Tanimë edhe sovjetikët vetë mund të arrijnë, në një kohë të caktuar, ta kuptojnë rëndësinë e lirisë. Ne po dëgjojmë shumë nga Moska mbi një politikë të re të reformave dhe të hapjes. Disa të burgosur politikë janë liruar. Disa agjenci të huaja lajmesh nuk janë më të bllokuara. Disa ndërmarrje ekonomike janë lejuar të veprojnë me më tepër liri nga kontrolli shtetëror. A janë këto fillimet e ndryshimeve më të thella në shtetin sovjetik? Apo mos janë vetëm ca lëvizje të vogla, të caktuara për të zgjuar shpresa të rreme në Perëndim, ose të forcojnë sistemin sovjetik pa e ndryshuar atë?

Ne e mirëpresim ndryshimin dhe hapjen, sepse ne besojmë që liria dhe siguria ecin së bashku, besojmë që përparimi i lirisë njerëzore vetëm e fuqizon kauzën e paqes botërore.

Ka një shenjë që mund të japin sovjetikët e që do të ishte e pagabueshme, një shenjë që do ta shpinte shumë përpara çështjen e lirisë dhe të paqes. Sekretari i Përgjithshëm Gorbaçov, nëse kërkon paqe, nëse kërkon begati për Bashkimin Sovjetik dhe Europën Lindore e nëse kërkon liberalizim, ejani te kjo portë! Zoti Gorbaçov, hapeni këtë portë! Zoti Gorbaçov, shembeni këtë mur!

Sot qyteti lulëzon, pavarësisht nga sfidat që nënkuptohen nga prania e këtij muri. Çfarë ju mban juve këtu? Sigurisht që ka shumë për të thënë për qëndrueshmërinë tuaj e për guximin tuaj shpërfillës. Por besoj se është diçka më e thellë, diçka që përfshin të gjithë pamjen e frymën e mënyrën e jetesës së Berlinit dhe jo thjesht ndjenjën. Askush nuk mund të jetojë gjatë në Berlin, pa u zhveshur plotësisht nga iluzionet. Ato duhen zëvendësuar me diçka që i ka parë vështirësitë e jetës në Berlin, por ka zgjedhur që t'i pranojë ato, diçka që Vijn ta ndërtojë këtë qytet të mirë dhe krenar në kontrast me praninë totalitare që e rrethon... Diçka që flet me zërin e fuqishëm të pohimit, diçka që i thotë “PO” këtij qyteti, që i thotë “PO” të ardhmes e që i thotë “PO” lirisë. Me një fjalë, unë do të thosha se ajo që ju mban juve në Berlin është dashuria, një dashuri e thellë dhe e qëndrueshme.

“Bota totalitare i sheh edhe simbolet e dashurisë e të lutjes si një fyerje”

Ndoshta kjo na shpie në rrënjë të çështjes, në dallimin më themelor që mund të ketë midis Lindjes dhe Perëndimit. Bota totalitare krijon prapambetje, sepse ajo i bën një dhunim të tillë shpirtit, shtyp hovet njerëzore për të krijuar, për të gëzuar e për t'u lutur. Bota totalitare i sheh edhe simbolet e dashurisë e të lutjes si një fyerje. Vite më parë, përpara se gjermano-lindorët të nisin rindërtimin e kishave të veta, ata ngritën një strukturë shekullare, kullën e televizionit në “Alexander Platz” (Sheshin Aleksandër). Në të vërtetë qysh atëherë autoritetet i ishin futur punës për të ndryshuar atë që e shihnin si cenin më të madh të kullës dhe e trajtuan sferën e qelqtë në majë me pikturime e me kimikate të çdo lloji. Megjithatë, edhe sot e këtë ditë, kur i bie dielli asaj sferë, që ngrihet përmbi të gjithë Berlinin, drita bën shenjën e kryqit. Edhe në atë pjesë të Berlinit, sikurse në të gjithë qytetin, simbolet e dashurisë dhe simbolet e lutjes nuk mund të shuhen.

Ndërsa shikoj një moment më parë nga Reichstagu, nga ai mishërim i unitetit gjerman, vura re ca fjalë të shkruara keq me spraj në faqe të murit, mbase nga ndonjë i ri berlinez: “Ky mur do të rrëzohet. Bindjet bëhen realitet. Po, në mbarë Europën ky mur do të rrëzohet”.



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Librat e shkruar nga autorë të huaj për Shqipërinë, gjithmonë janë me interes dhe shfletohen shpejt për të mësuar se çfarë shkruajnë e si e trajtojnë Shqipërinë, njerëzit, natyrën dhe të gjitha problemet shoqërore, politike dhe ekonomike që shikojnë dhe prekin gjatë udhëtimeve, vizitave apo dhe si pushtues e kalimtarë në territorin shqiptar. Libri “Shqipëria etnike dhe gjeografike”, i autorit Eugenio Barbarich, një monografi antropogjeografike e botuar në Itali në vitin 1905, na vjen sot në Shqipëri pas 115 vitesh, duke parë dritën e botimit në vendin për të cilin është shkruar.

I palodhuri në vite për gjetjen e “Rrënjëve” dhe publikimin e një gazete prestigjioze të titulluar “Rrënjët”, mjeshtri i patriotizmit shqiptar Hasan Aliaj, në bashkëpunim me Fitije Picari, prej vitesh janë përkushtuar për të nxjerrë në dritë këtë libër të veçantë, si nga përmbajtja, por dhe nga paraqitja e fakteve historike, etnike e gjeografike, etj. Këta janë të bindur se si askush tjetër deri më sot, Eugenio Barbarich, na ka dhënë një vepër, ku çdo shqiptar në çdo trevë e kudo në diasporë, kur e lexon këtë libër, ndihet krenar për prejardhjen e origjinës së tij të lashtë. Libri është aktual dhe origjinal. Ai na sjell Shqipërinë e asaj kohe në një tablo krejt të veçantë të natyrës shqiptare dhe me të gjitha karakteristikat e shqiptarit. Jehona e librit në këto vite ka trokitur shpesh në truallin shqiptar, por ja që u desh puna dhe munda i Hasan Aliajt e Fitije Picarit, si dhe i përkthyeses Meri Gjoleka Shaqiri, ta sjellë tepër origjinal dhe të këndshëm në gjuhën shqipe. Meritë ka dhe redaktori Andrea Llukani, në pastërtinë e fjalës sipas drejtshkrimit shqip, realizuesi i grafikës së librit Ertel Shaqe, si dhe botuesi, gjithmonë me kulturë dhe estetikë, Botimet M&B, të drejtuara me mjeshtëri nga Bujar Karoshi e Majlinda Karoshi. Gjej rastin t’i falënderoj për prurjen në shqip të kësaj vepre unike dhe gjithëpërfshirëse të analizës antropogjeografike të Shqipërisë.

Në vitin 1912, Vico Mantegazza ka shkruar se në italisht ka disa publikime interesante e me shumë vlerë historike për Shqipërinë të disa autorëve si: prof. Baldacci, prof. Galanti, letrat e Markezit San Giuliano të publikuara në gazetën “Il Giornale d’Italia”, gazetari Ugo Ojeti etj. Ndër këto botime veçohet Barbarich, i cili me veprën e tij “Albania” me të vërtetë me vlerë, e quan me modesti monografi antropogjeografike. Eugenio Barbarich ka qenë një oficer me shumë kulturë, i cili, dhe pse i ri, ka realizuar botime me rëndësi, por libri mbi Shqipërinë, e ka bërë këtë libër klasik. Në këtë libër nuk mungon bollëku i informacionit. Me interes për ne si oficerë të një gjenerate tjetër është që të njohim më mirë për këtë ushtarak, se si është gjendur në Shqipëri, apo ka studiuar pa qenë këtu dhe ka bërë një vepër që dhe sot ka vlera klasike ushtarake, ka një analizë të studimit të terrenit shqiptar, sikur të kishte lindur këtu. Me interes do të ishte që libri të ishte shoqëruar dhe me një bibliografi të këtij autori dashamirës për Shqipërinë.


Në libër i ka bërë një rikonjicion të hollësishëm gjendjes konkrete të Shqipërisë, ka përshkruar një analizë të thellë, si dhe ka dhënë disa dukuri të natyrës dhe të njeriut shqiptar me karakteristikë dhe veçori, të cilat e rritin vlerën e librit dhe thellojnë njohjen për tokën shqiptare. Librin autori e ka paraqitur në tri pjesë. Në pjesën e parë të titulluar “Gjeografia e përgjithshme e Shqipërisë”, zënë vend pesë kapituj që përshkruajnë: terrenin, brigjet, ujërat, klimën dhe bimësinë. Në pjesën e dytë të titulluar “Elementet antropogjeografikë” në katër kapituj, ku trajtohet: popullsia dhe gjuha, historia, traditat, ekonomia dhe administrata publike. Ndërsa në pjesën e tretë të quajtur “Qarkulli rrugor dhe itineraret rrugore”, zënë vend të dukshëm kapitujt: rrjeti rrugor dhe itineraret rrugore.

Libri në dukje është një libër i thjeshtë, por në brendësi të tij, autori si ushtarak dhe njohës i mirë i terrenit dhe i natyrës shqiptare futet në thellësi të shekujve dhe zbulon, analizon dhe përgjithëson gjithë rrugëtimin disa mijëra vjeçarë të Shqipërisë, në një literaturë të bollshme dhe në një terren të gjerë të gjeografisë shqiptare.

Autori në parathënie thekson se “njerëzit dhe vendi shfaqen të pandryshueshëm në Shqipëri gjatë shekujve dhe i takon gjeografisë pozitive dhe historisë kritike t’i nxjerrë në pah me një studim të qartë dhe të plotë”. Me pak fjalë autori na përshkruan gjeografinë e Shqipërisë, ku thekson se “Dy barriera të mëdha gëlqerore, si bastione të frikshme, kufizojnë pamjen e kësaj krahine të gjerë nga veriu dhe jugu, jo shumë e ndjeshme ndaj marrëdhënieve fitimprurëse të shkëmbimeve, të tregtisë dhe peripecive të qytetërimeve dhe perandorive të ndryshme: një gamë e relievave kristalore i lidh të dyja bastionet në drejtim të lindjes: më në fund një perde e përbërë nga terrene të sheshta hapet drejt perëndimit, shtrin dorën drejt rrugëve detare dhe përmes të njëjtit terren, i lë vendin një rruge natyrore tranziti, një çarjeje të madhe përgjatë harkut të poshtëm dinarik”.

Duke analizuar të gjithë dukuritë e natyrës shqiptare, autori vjen në përfundimin se “krenaria e banorëve, natyra e vendeve, e përshtatshme për luftë të ashpër dhe të pathyeshme malore, ngushticat e lumit Drin nga njëra anë dhe ato të Këlcyrës nga ana tjetër, ishin një pengesë e fortë, nga përpjekjet e perandorive të këtyre qytetërimeve fqinje, për një asimilim më të gjerë të popujve. Prandaj, për këtë arsye, brendësia e bastioneve gëlqerore - nga fiset shqiptare të Alpeve të Mëdha, nga Dukagjinët, Mirditorët, e deri te Zagoritët e Suliotët - ka ruajtur në çdo kohë karakteristikën e vet të një origjinaliteti të sinqertë dhe krenar”. Duke analizuar të gjitha dukuritë në libër, Shqipëria shfaqet si një rajon i veçantë tranziti dhe depërtimi, vërtet tipik për faunën, për kushtet sociale, historike dhe politike të popullit të saj. Autori shprehet se

Shqipëria në sytë e të huajve



“Shqipëria në thelb është si një person real, (i gjallë)”. Autori arrin në përfundimin tjetër se “këtu njeriu, ndonjëherë në kushtet më të vështira të mbijetesës dhe në planin afatgjatë, ka gjetur përshtatjen me tokën dhe është bërë interpretuesi besnik, i fortë dhe inteligjent i saj”.

Monografi ka një renditje sintetike për studime dhe relacione. Gjatë leximit të librit gjejmë disa parime thelbësore, të tilla si marrëdhënie të gjenezës, morfologji të tokës, dukuri të tokës që rrjedh nga veprimtaria e njeriut. Këto parime lidhen me historinë, me politikën dhe me ekonominë shqiptare.

Për sa i përket historisë, autori dëshmon për frymën e pashuar të krenarisë dhe pavarësisë së popullit shqiptar; dokumenton originalitetin e tij dhe betejat e tij fitimtare ndaj veprimeve dhe reagimeve të qytetërimeve dhe perandorive të ndryshme. Gjatë historisë, populli shqiptar ka përjashtuar çdo koncept të zotërimit të territoreve të vendeve të tjera, kjo sipas këtij koncepti ishte një ndërmarrje tepër e mundimshme dhe jofitimprurëse për të përballuar gjithsesi shpenzimet e joshjeve të tilla që mund të nxiten prej këtij koncepti apo nga kushdo.

Autori në libër sjell dhe një argument për sipërfaqen e përgjithshme të Shqipërisë, e cila sipas tij llogaritet në 58.000 km2, ndërsa autorë të tjerë e llogarisin në 90-103.000 km2 etj.

Libri për çështjet historike në rreth 50 faqe trajton luftërat e zhvilluara në territorin shqiptar, duke filluar që nga epoka iliro-romake. Dokumentet e para historike dëshmojnë rëndësinë e rajonit shqiptar, duke theksuar se ai është një rrugë kalimi midis Ballkanit dhe brigjeve të pellgut të Adriatikut. Në këtë territor janë zhvilluar luftime të ashpra nga fiset ilire, fillimisht për t’u konsoliduar në tokat e tyre, e më pas për të kundërshtuar dyndjet e mëvonshme të popujve të ngjashëm, të cilët, përgjatë rrugëve të Ilirisë dhe të trevës së Shqipërisë qendrore, tentonin të hapnin një rrugë të lehtë midis Lindjes dhe Perëndimit.

Luftërat e ashpra dhe krenare i dhanë mbretërisë ilire një zhvillim të madh, veçanërisht kundër kolonive helene të bregdetit: ndër to vlen të kujtojmë luftërat e taulantëve kundër Durrësit, të përshkruara në mënyrë klasike nga Tukididi. Që nga lufta e parë maqedonase e vitit 215 p. K. kur Filipi depërtoi me një ushtri të madhe deri në Apoloni, në luftën e dytë maqedonase 200 p. K. përsëri në Apolonisë, Filipi u gjend përballë një shfaqjeje të jashtëzakonshme njerëzish të armatosur, hoqi dorë nga plani për të zbritur në Shqipëri dhe në fillim të luftës së tretë maqedonase, Genci, më i forti nga të gjithë feudalët ilirë, i bëri ballë dhe nuk lejoi ambicien e pafundme për zgjerim territoresh. Ishte viti 168 p. K.

Autori jep një panoramë të gjerë të zhvillimit të luftës midis Jul Cezarit dhe Pompeut në vitin 48 p. K. Midis përleshjes së tyre autori thekson forcën e këtyre dy ushtrive, humbjen e Cezarit se i mungonte largpamësia e shfaqur në ekspeditat e Britanisë, për sa i përket sigurisë së anijeve detare dhe sundimit të detit. Ndërsa Flota e Pompeut dogji flotën armike, bllokoi brigjet shqiptare dhe epirote dhe portin e Brindisi, vraoi drejt Adriatikut; kështu që ndërsa ushtria e Pompeut e mbledhur rreth Durrësit furnizohej lirisht nga deti, ushtria e Cezarit ishte në vështirësi logjistike pothuajse të pariparueshme rreth Apolonisë. Pompeu nuk jepte shenja për veprime vendimtare, pikërisht me qëllimin për të rraskapitur forcat armike me mungesën e rezervave: ai forcoi Durrësin, tërhoqi çezarianët atje dhe vendosi garnizona përgjatë rrugëve të Shkumbinit.

Autori na ka përshkruar gjerësisht rrugën kryesore të tranzitit shqiptar që ishte Egnatia. E ndërtuar ekskluzivisht për qëllime ushtarake, për t’i bërë më të lehta dhe më të shpejta lëvizjet e legjioneve të Romës - nga

Brindisi në Maqedoni, në Trakë, Danub, Greqi, Detet Levantine dhe Azinë e Vogël - kjo rrugë dallohet nga të gjitha të tjerat e depërtimit ballkanik, pasi ka përfaqësuar në çdo kohë lidhjen më të shpejtë dhe më efektive midis qytetërimeve lindore dhe atyre perëndimore.

Ndërsa për zhvillimet në epokën bizantine, autori thekson se kuptimi i historisë mesjetare dhe bizantine shqiptare përmbledhet në ngjarjet e qyteteve të saj detare dhe në përpjekjet e vazhdueshme për të ruajtur hegemoninë e vet. I tillë është karakteri i principatave autonome dhe i republikave të lira tregtare më shumë në reciprocitet me portet e Levantit, si Shkodra, Durrësi, Korfuzi dhe Arta. Ishte koha kur në këtë rregullim politik dhe administrativ, Shqipëria u pushtua nga dyndjet barbare. Kjo periudhë historike e trazuar, e karakterizuar nga përpjekjet për zotërimin e daljeve në det të Shqipërisë dhe për ruajtjen e autonomisë së tyre tregtare - nga të cilat republikat kryesore detare të asaj kohe kishin avantazhe të paçmueshme. Kjo periudhë pushoi si e tillë me lulëzimin e perandorisë së dytë bullgare dhe përballë hegemonisë serbe, për shkak të grindjeve dhe luftërave të shkaktuara nga afirmimi i këtyre supremacive.

Ndërsa Shqipëria kaloi një valë traditash kalorësiake, historish të principatave feudale, por dhe këtu filloi lufta e princërve trashëgimtar. Më tej autori përshkruan marrëdhëniet italo-shqiptare të kësaj periudhe, ndalet te sundimi i anzhuinëve në Shqipëri, si ra dhe u zhduk ai etj.

Ndërsa historia e Gjergj Kastriotit dhe ndjenja e bëmave të tij zbulojnë një mësim të thellë rreth meritave dhe defekteve të njerëzve dhe truallit shqiptar. Bëmat e tij ushtarake ofrojnë një nocion të mrekullueshëm praktik të këmbënguljes së rezistencës që paraqet kjo tokë në luftën mbrojtëse, në vetvete, e përmirësuar me ndihmën e artit, e pabesueshme dhe e fshehtë nga pritat, kurthet dhe intrigat e çdo lloji, karakteristikat e artit ushtarak të Kastriotit.

Autori i përshkruan shqiptarët: “Janë të hipur mbi kuaj shumë të shpejtë, të mësuar me beteja malore, me sulme të shpejta, me luftëra guerile të vazhdueshme dhe të përgjakshme, i ndjekin këmba këmbës armiqitë. Ndërsa kalorësia italiane e kohës, ishte e penguar nga armatura e rëndë, nuk mundi të mbrohej nga këta sulmues të guximshëm shqiptarë, që mbollën kudo masakër dhe frikë.

Luftërat e Kastriotit janë në thelb të një natyre mbrojtëse. Kastrioti i priste armiqitë në kufirin midis Maqedonisë dhe Shqipërisë, në ngushticat klasike të Dibrës, nën malet e Mokrit. Skënderbeu rrallëherë shtyhej ta linte këtë qëndrim mbrojtës për të zbritur në rrugët e Ohrit, por ato ishin përpjekje të ndrojtura, pothuajse mosbesuese edhe nga populli i tij dhe nga ata prej të cilëve rridhte Kastrioti. Ky qëndrim u shfaq në fushatën e vitit 1453, në atë të vitit 1461 dhe në shumë të tjera”.

Autori i bën një përshkrim të hollësishëm Shqipërisë nën pushtimin turk dhe principatat e pavarura të Bushatllinjve në Shkodër dhe të Ali Pashait të Janinës.

Pastaj vëmendjen e përqendron në vitin 1878, kur u krijua Lidhja e Përgjithshme për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë Shqiptare. Kjo Lidhje kishte qendër Prizrenin për Shqipërinë veriore dhe Gjirokastrën për atë jugore: pika e përbashkët e kontaktit mes dy vatrave të propagandës kombëtare Shqiptare ishte Elbasani. Lidhja shpalli menjëherë nevojën për të arritur krijimin e një autonomie shqiptare, me kryeqytet Ohrin.

Autori shprehet se “Lidhja Kombëtare Shqiptare me përparimet e saj, me përhapjen e saj, në fakt kreu një vepër propagande të vërtetë të ndjenjës patriotike përbashkuese shqiptare. Ajo tentoi të bashkojë në mënyrë të pandashme grupet etnike dhe fetare, të zbusë format e shfaqjeve tradicionale separatiste, nën mbrojtjen e gjerë të statuteve të autonomiste; me pak fjalë, të formësojë ngadalë, por me siguri, me arsim e njohuri reciproke gjithë popullin shqiptar në një trup të vetëm energjish, kompakt, të vetëdijshëm për interesat dhe dëshirat kolektive, si dhe për të drejtat e veta për një ndërgjegje kombëtare.

Qëllimi i Lidhjes Kombëtare, thuhet në një nga nenet e statutit të saj, është të sigurojë mbrojtjen dhe kthimin e territoreve të atdheut. Çdo shqiptar mund të marrë pjesë, duke u betuar në momentin e pranimit, për të mbrojtur me të gjitha mjetet autonominë e plotë kombëtare. Çdo anëtar i Lidhjes që, duke shpërfillur detyrat e tij, kryen tradhti, do të masakrohet në mënyrë të pamëshirshme.

Koncepti i autonomisë, si forma politike që i përshtatet më së shumti nevojave historike dhe ekonomike të popullit shqiptar, është skicuar gjithashtu edhe në statutet e Lidhjes. Ky koncept rilidhet, me rendin gjeografik dhe ekonomik, me detyrën si rrugë tranzitore e lirë në kohët më të begata të Shqipërisë, midis detit Adriatik dhe Egje; me rendin historik për mundësinë e bashkëjetesës, nën të njëjtat forma liberale të republikave aristokratike ushtarake, nga popujt luftëtarë, detarë, baritorë dhe bujqësorë.

Së fundi, në rendin moral, vetë autonomia mund të lejojë ribashkimin e një grupi të vetëm popullsisht, sektesh dhe gjuhësh të ndryshme. Format e dëshiruara nga Lidhja Kombëtare Shqiptare janë të lidhura në thelb nevojën për të zgjedhur, në një kuptim të ngjashëm, strukturën politike dhe administrative të një rajoni, i cili në aspektin ekonomik, gjeografik dhe etnografik, ka korrespondencë të përsosur me atë shqiptare. Domethënë Maqedoninë, e cila përfaqëson fundin e Rugës Egnatia të së shkuarës dhe gjysmën e trafikut dhe të tregtisë, që do të zhvillohet midis pellgut të poshtëm të detit Adriatik dhe Egjeut.

Autori në çdo germë të librit për Shqipërinë shfaq një respekt dhe mirënjohje për kulturën, traditat, zakonet dhe përpjekjet e këtij populli vital, këmbëngulës dhe krenar në trojet e veta. Ja vlen që të lexohet dhe të shkruhet për të.

Edhe një herë falënderojmë të nderuarin Hasan Aliaj për këtë prurje të re dhe ndihmesë të vyer në letërsinë e botimeve në shqip, të shkruar nga një autor i huaj për Shqipërinë, por dhe në kontributin për njohjen e historisë ushtarake të shkruar.



Përgjatë vitit 2024, vijojnë aplikimet për pranimin e kandidatëve për:

- Ushtarë/ Detarë aktivë përgjatë tre periudhave të rekrutimit (Prill, Shtator, Dhjetor)
- Studime Ushtarake në Akademinë e Forcave të Armatosura
- Studime Ushtarake në Akademinë “West Point” në SHBA
- Studime Ushtarake në Itali
- Studime Ushtarake në Turqi
- Studime Ushtarake në Greqi
- Studime Ushtarake në Mbretërinë e Bashkuar